

Prof. Dr. Ferid Hudhri, kur ishte redaktor për artet figurative në gazetën "Drita", e ka botuar këtë shkrim 40 vjet më parë. Tani kemi mësuar se riprodhimet e këtyre tablove të piktorit të famshëm francez i kishte sjellë në Tiranë patrioti i shquar Bruno Selimaj.

"Katër tablo të piktorit Leon Zherom", një shkrim i botuar për Shqipërinë në vitin 1984 në gazetën "Drita"

Nga Ferid Hudhri



Leon Zherom:
"Shqiptarë
duke luajtur
shah"
2 shkurt 1859

NTAHEN ÇMIMET KOMBËTARE TË LETËRSISË PËR VITIN 2023

(fq. 5)

SHËNIME MBI LIBRAT

Romani "Komploti" i Ben Blushit
Ajo çfarë autori ka drojë se
mund të na ndodhë

Nga Nikollë Camaj (fq. 7)

Tri poezi me dritë për gratë
shqiptare nga Lefter Çipa

Nga Prof. Dr. Bardhosh Gaçe (fq. 8)

Rreth vëllimit poetik të Kujtim Shalës, "Idioma"
Imazhe testamentale mbi
luftën, mbijetesën dhe
dashurinë

Nga Agron Tufa (fq. 10)

Mbi librin "Arbëreshët, shqiptarët e Italisë"
ARBËRESHËT, SI I PA DHE
SI I NJOHU FATMIR TOÇI
Nga Shpendi Topollaj (fq. 12)

Libri me poezi i Mero Bazes, "Shi me baltë"
Dimensioni i dhembshurisë
dhe humanizmit në poezinë
e Mero Bazes

Nga Leonidha Mërtiri (fq. 9)



Receptimi i procedimeve narrative të Gogolit dhe Turgenievit në rrëfimin e Kutelit

Nga Prof. Dr. Blerina Suta

Përfshirja e lugetërve në jetën e të gjallëve, disa të këqinj dhe disa të mirë, situata rituale të luftës kundër shpirtave të këqinj, sjellin ngjyrën e një Shqipërie rustike, të zhveshur aty për aty nga shprehjet më domethënëse të jetës së saj shpirtërore. Supersticionet rustike, të jetuara si "të vërteta" nga të gjithë anëtarët e bashkësisë, janë të përhapura në krejt hapësirën artistike të veprës. Kjo teknikë thekson nivelin e ulët të jetës shpirtërore në periudhën historike të tranzicionit dhe nevojën për të rivendosur cilësitë më të mira të identitetit shqiptar.


Këto detaje invariante karnavaleske gjenden shpesh me ngjashmëri të habitshme në krijimtarinë e Turgenievit dhe Gogolit.

(fq. 14)

In memoriam
ASTRIT BISHQEMI,
shkrimtari dhe studiuesi i
shquar i letërsisë për fëmijë
Nga Xhahid Bushati (fq. 5)

**BUZË VALBONËS ËSHTË
PIRË VERË DY MIJË
VJET RRESHT**
Nga Mehmet Elezi (fq. 6)

JACQUES BARZUN
Artisti u lind
Përktheu nga origjinali Flurans Ilia



(fq. 24)

BIBLIOTEKË

Besnik Mustafaj (fq. 16)

Fati i marrë

Arta Maxhuni (fq. 17)

Indqenie

Odise Kote (fq. 18)

Heshnja

Shpresa Kapisyzi (fq. 19)

Ti, grimcë pluhuri

Roland Gjoza (fq. 21)

Nju-Jorku në një gotë vere

Shënime mbi romanin "Babë u krye!", Bislim Ahmetaj

**Drejtësia si shërim,
si shpëtim!**

Nga Emi Krosi (fq. 13)

Libri me poezi "Njeriu i diellit" të Alisa Velajt

Gjuhë e re poetike

Nga Diamanta Zalta (fq. 13)

**"Pinoku" - një përrallë
e misterhme ezoterike**

Nga Zija Vukaj (fq. 20)

Prof. dr. Ferid Hudhri, kur ishte redaktor për artet figurative në gazetën “Drita”, e ka botuar këtë shkrim 40 vjet më parë. Tani kemi mësuar se riprodhimet e këtyre tablove të piktorit të famshëm francez i kishte sjellë në Tiranë patrioti i shquar Bruno Selimaj

“Katër tablo të piktorit Leon Zherom”, një shkrim i botuar për Shqipërinë në vitin 1984 në gazetën “Drita”

Nga Ferid Hudhri

Emri dhe fama aq e madhe e Ezhen Delakruasë ka bërë që disa piktorë të tjerë romantikë të mos e gëzojnë atë popullaritet të mjeshtër të madh. Megjithatë, në historinë e artit të vendit të tyre, madje edhe në atë botërore, ata zënë një vend të rëndësishëm për vlerat artistike që arritën. Nuk është e rastit që për piktorin Aleksandër Gabriel Deka, autor i tablosë “Valltarët shqiptarë”, të shkruhet se në disa vepra ishte po aq gjeni sa edhe Ezhen Delakrua. Edhe piktorë të tjerë, me ekspozita apo vepra në periudha të veçanta të krijimtarisë, arrijnë “maja të larta”, duke mos mbetur pas atij mjeshtri. Një ndër ta ishte edhe piktori Leon Zherom.

Në Ekspozitën Universale të Parisit më 1855 ai mori një nga vlerësimet më të larta. Tablotë që paraqiti aty u çmuan më shumë se peizazhet e Korosë, madje edhe kërkesat për veprat e tij nga Anglia e vende të tjera ishin më të mëdha se edhe për autorë të shquar. Pas kësaj ekspozite ai vlerësohej si një nga mjeshtërit më të mëdhenj të shekullit XIX.

Leon Zherom (Jean-Léon Gérôme, 1824-1904) ka qenë nxënës i piktorit të njohur Pol Delarosh. Por ai u shqua edhe vetë si mjeshtër që në krijimet e para. Pas udhëtimeve që bëri në Lindje, ku e tërhoqën shumë ngjyrat e bukuria e kostumeve si dhe peizazhi plot dritë, ai e përqendroi krijimtarinë e tij mbi ato motive. Realizoi shumë tablo dhe sa herë që i ekspozonte fitonte admirimin e shikuesve, të studiuesve dhe historianëve të artit që vazhdimisht shkruanin për “mjeshtërinë e këtij piktori që sillte me vërtetësi skena interesante nga Lindja”. Tablotë e tij me ato motive, përgjithësisht në përmasa të vogla, janë vlerësuar si “mjaft piktorike, të kompozura bukur dhe me një fakturë të pasur” (“Petit Larousse de la peinture”, v. 1, f. 709, Paris, 1979). Në

vitin 1863 ai u bë profesor i pikturës në Shkollën e Arteve të Bukura të Parisit dhe prej studios së tij kanë dalë disa piktorë të njohur. Në krijimtarinë e L. Zheromit bëjnë pjesë edhe disa skulptura të bukura.

Gjatë udhëtimeve që bëri në Lindje, piktori kaloi edhe në vendin tonë dhe realizoi disa tablo, me katër prej të cilave u njohëm nëpërmjet

riprodhimeve në fotografurë, sipas origjinaleve. Njëra prej tablove me motive nga Shqipëria mbahet edhe si një nga veprat më të bukura të autorit me temën e Lindjes.

Në të katër veprat ndihet menjëherë mjedisi shqiptar. Figurat me qëndrimin, psikologjinë, kostumet e orënditë përreth si dhe objekte të tjera japin qartë veçoritë kombëtare.



Sapo sheh tablotë bindesh edhe për vlerësimin e një studiuesi të piktorit që thotë se në pikturat e Zheromit “shqiptari, turku, siriani njihen që me vështrimin e parë, pasi në shprehjen e tij etnografike autori është gjithnjë i vërtetë” (“Gerome”, Nju-Jork 1881, f. 5). Për krijimet me motive nga Lindja, ku bëjnë pjesë edhe ato kushtuar vendit tonë, shkrimtari dhe kritiku i njohur i letërsisë së artit francez Theofil Gotje ka shkruar se “Zherom ka një sy të shpejtë dhe të saktë, një dorë që punon me zgjuarsiri dhe siguri, duke dhënë me datat, po aq me besnikëri sa dhe një fotograf dhe më të gjitha ai ka një sens që ne do ta quanim ekzotik, i cili e ndihmon të dallojë ndryshimet karakteristike të secilit komb” (“Gerome”, f. 6).

Tablotë me temë nga vendi ynë, veç vlerave artistike, janë të rëndësishme edhe për motivet që trajtohen. Njëra titullohet “Shqiptarë duke luajtur shah”. Është realizim i vitit 1859. Në të katër tablotë shihet një interes i madh për pikturimin me besnikëri të kostumeve kombëtare. I çmuar për gjithë krijimtarinë e tij si një realist i madh, mund të themi se Zheromi është autori i huaj që na i pasqyron më saktë e më qartë kostumet tona kombëtare, duke pikturuar deri në detaje të imëta pjesë të veçanta e stolisje të vogla, të cilat veç një sy i vëmendshëm dhe një dorë e sigurt si e atij mjeshtri mund t’i realizonte me aq vërtetësi. Nëpërmjet veprave të tij, ku paraqiten me dhjetëra figura shqiptarësh, jepen edhe shumë variante kostumesh të plota me të gjitha elementet, që nga çorapet e deri te shamitë e kokës e veshje të tjera të ndryshme. Por me gjithë këtë saktësi të pikturimit të kostumeve dhe elementeve të tjera piktori, si një mjeshtër i vërtetë, nuk krijon tablo të karakterit etnografik. Ato janë plot jetë dhe me natyrshmeri të tërheqin në atmosferë intime e jetësore. Vendosija e figurave në mjedise të gjera, me hapësira të mëdha, ku jepet mundësia për të dhënë një përfytyrim më të

plotë të jetës shqiptare të atyre viteve, bën të ndalesh më gjatë në tablotë e tij për të soditur jetën e njerëzve. Në krahasim me veprat e Delakruasë, Dekasë etj., në tablotë e Zheromit shqiptarët jepen në çaste të qeta. Megjithatë, ndihet edhe atmosfera e viteve kur ata luftonin për trojet e tyre. Në të katër tablotë, ndonëse paraqiten çaste intime, figurat kanë armë, që janë gjithashtu të stolisura si dhe kostumet. Madje edhe në tablonë që titullohet “Shqiptarë duke u falur” piktori në sfondin e një muri të pastër, në një sipërfaqe të gjerë ka pikturuar nëntë pushkë që u përkasin shqiptarëve që falen, midis tyre edhe një djaloshi të vogël. Armë të varura në mure dhe pranë këmbëve shihen edhe në tablonë “Shqiptarë duke kënduar”, ku në plan të parë është një djalosh që këndon me çifteli, si dhe në tablonë e titulluar “Shqiptarë”, ku paraqiten dy figura (ndoshta ata e bir) para portës së shtëpisë.

Me këto vepra (është e mundur që të ketë edhe të tjera) piktori Leon Zherom duhet vlerësuar si një nga autorët më kryesorë që ka trajtuar temën shqiptare, jo vetëm për numrin e tablove dhe rëndësinë e personalitetit të tij, por edhe për realizimin e bukur artistik të tyre. Veç vlerave të tjera, aty janë skalitur dhjetëra tipa të veçantë, ndihet dashuria e autorit për të dhënë veçoritë karakteristike nëpërmjet një gjuhe piktorike të qartë dhe tërheqëse. Nëpërmjet veprave bindesh se autori e ka njohur mirë botën shqiptare të atyre viteve, historinë shqiptare. Bagazhi i tij artistik ka qenë i pasur. Për realizimin e tablove ai ka qenë i mbarsur më parë me mbresa të shumta, me skica, etyde dhe studime që përbëjnë gjithashtu një pasuri për kulturën tonë.

Shumë nga veprat e Zheromit, pasi u ekspozuan në Amerikë, mbetën atje duke u bërë pronë e muzeve dhe koleksionistëve privatë. Edhe origjinalet e tablove me motive nga vendi ynë kanë mbetur në muze të Nju-Jorkut. Më 1972 u hap një ekspozitë me gjithë veprat e Zheromit që ndodhen në Amerikë.

(Marrë nga gazeta “Drita”,
e diel, 1 korrik 1984)



Një foto me delegacionin nga Nju Jorku, dalë në një nga ambientet e Hotel Dajtit.

Në rreshtin e parë, nga e majta në të djathtë:
Anette Lantosh (bashkëshortja e kongresmenit), Sofokli Lazri,
kongresmeni Tom Lantos dhe Zef Mazi.
Në qendër është kongresmeni Joseph J. DiGuardi
Në rreshtin e dytë, i katërti nga e majta, është Bruno Selimaj

Pas tridhjetë vitesh, me patriotin Bruno Selimaj, në restorantin e tij në qendër të Manhattan (Bruno's Club a 240 e 58 st. New York 10022).

Në vitin 1996 filluam bashkëpunimin për botimin e librit “Kombi”, me shkrime të autorëve nga të gjithë trojet shqiptare, që kishin në fokus çështjen shqiptare në prag të shekullit XXI.

Bruno, së bashku me mikun e tij, të ndjerin Dino Asanaj, e mbështetën këtë projekt.

Në muret e restorantit, qindra foto të njerëzve më të shquar të kombit shqiptar si dhe të politikanëve amerikanë, dëshmojnë për mbështetjen që Bruno ka dhënë pa u kursyer për luftën dhe Pavarësinë e Kosovës.

Ishte gëzim ta takojë Brunon sot, ku i vetmi ndryshim që të binte në sy, ishte mungesa e flokëve të tij të zinj, ndërsa mikpritja dhe fisnikëria e tij ishte më e dukshme se kurrë.

Nga Biseda me Brunon mësova se ishte pikërisht ai që kishte sjellë në Tiranë katër riprodhimet e tablove të piktorit të famshëm francez Leon Jerome. Kishte ardhur në Tiranë nga New York nëpërmjet kufirit tokësor me Kosovën. I shoqëruar nga dy kongresmenët Tom Lantosh dhe DiGuardi.

Brunoja pranoi me sinqeritet se katër tablotë do t'ia dhuronte Galerisë së Arteve në Prishtinë, por kishte qenë z. Avni Spahiu, atëherë korrespondent i “Rilindjes” në New York (Në Kosovën e lirë u bë një nga ambasadorët e saj në Washington) i cili i sugjeroi Tiranën. Në Prishtinë me shumë gjasa serbët do t'i shkatërronin.

Në foto: Patrioti i shquar Bruno Selimaj dhe kryeredaktori i gazetës, Bujar Hudhri, në Bruno's Club, në New York, 13 dhjetor 2024



1.

Pesëmbëdhjetë-njzet minuta në këmbë nga qyteti Bajram Curri shpalohej lagjja Elezaj. Lloj-lloj pemësh, ara e kroje. Kashnjete pa fund e mbështjellin palë-palë. Në pjesën jugore të saj, diku kah mesi i rrugës që e lidh me qytetin, shtrihen pjerrëtazi do livadhe gjysmëdjerrë. Këto livadhe quhen *Vneshta*. As sot, as në qindvjetëshin e shkuar, të moshuarit nuk dinin me kallëzue për ndonjë vreshtë në ato toka. E vetmja pemë ka qenë një dardhukël e moçme, diku në skaj. Dhe do shorte (fidanë) të mbjellë nga kooperativa, që nuk u rritën e nuk u bënë pemë kurrë.

A ka pasur vreshta aty? Në qoftë se po, kur u rrenuan? Përse?

Duke ndjekur udhën nga Vneshtat për në brendësi të lagjes, pas qindra metrash ecje përmes gështenjash të dendura, ngjitesh në një kodër. Aty pyetjet e mësipërme bëhen më intriguese. Quhet *Kodra e Vneshtës*. Ndryshe nga Vneshtat e zhveshura, Kodra e Vneshtës mbulohet me gështenja madhështore, trungjet e tyre janë të veshura me myshk. Specialistët i vlerësojnë rreth treqindveçare. Netëve të vjeshtës me erë e shushurimë fletësh kokrrat e pjekura pikojnë duke kërcitur, thua janë mollë.

Emri *Kodra e Vneshtës* tregon se ajo kodër dikur ka qenë mbjellë me rrush. Vreshtat kanë vijuar nga livadhet që quhen *Vneshta*, nëpër pyllin me gështenja, deri në kodër të Vneshtës. Dhjetra hektarë.

Traditën e kadtshme të rritjes së rrushit në këtë anë përgjatë qindveçarëve e mbështet edhe një e dhënë kryefortë nga kultura lëndore.

Kah mesi i viteve 1960 pronari i Vneshtave tashmë të kolektivizuara, miemri i të cilit, edhe ai, është pikërisht *Vneshta*, nis me çelë themelet e një shtëpie të re. Pak më poshtë, në rrafsh, në qendër të katundit, skaj shtëpisë së vjetër. Rastësisht gjatë gërmimeve zbulohet një gur varri i madh. Kishte një përkushtesë në latinisht, të zbuluar me një amforë të gdhendur në fund të saj. Prej amforës përhapen gjethet e rrushit, duke rrethuar në trajtë kurore përkushtesën dhe krejt sipërfaqen e gurit. Sipas vlerësimit të arkeologëve, guri i përket kulturës vendase dardane, me ndikime prej kulturës romake. Është i qindvjetëshit të parë ose të dytë pas Krishtit. Ky gur, me përmasat 182 X 61 X 25 cm dhe me numër inventari 1320, mund të shihej në Muzeun Kombëtar në Tiranë, deri sa ky Muze u mbyll.

Por nuk mbaron këtu.

2.

Në krahun tjetër të lagjes Elezaj, në anën veriore, pak a shumë simetrike me Vneshtat dhe me Kodrën e Vneshtës me gështenja treqindveçare, është një vend gjysmëlivadh, gjysmëpemëtoje, gjysmëdjerrinë. Në femininë e autorit të këtyre shenimeve ky vend ka qenë joshës sidomos për katër-pesë qershi të mrekullueshme. Të larta e degëgjera, pushtonin hapësirën me kokrrat e mëdha plot shkëlqim, që ta shkëlqin syrin qysh larg.

Ky vend nuk quhet *Vneshta*. Quhet *Vështë*, me *ë* (hundore). Por vreshtë aty nuk mbahet mend kurrë.

Vihet re se në këtë emër mungon bashkëtingëllorja *n*, që në toskërisht u shndërrua në *r* me dukurinë e rotacizmit. Por

BUZË VALBONËS ËSHTË PIRË VERË DY MIJË VJET RRESHT

Nga Mehmet Elezi



zanorja e në rrokjen e parë është hundore e pastër, dëshmi e pranisë së dikurshme të *n*-së. Emri fillimisht ka qenë *venshtë*, *n*-ja është përngjashmuar (asimiluar), duke lënë pas një *ë* (hundore).

Arsyeja thotë se tri emërvede të kadtshme ngat shoqi-shoqit, me të njëjtën prejardhje, por në dy trajta fonetike, dy prej tyre *Vneshtë*, përkatësisht *Kodra e Vneshtës*, dhe i treti *Vështë*, kanë fotografuar dy kohë të ndryshme larg shoqja-shoqes. Mbase dy epoka.

Koha kur është shqiptuar *venshtë* dhe koha kur është shqiptuar *vështë* kanë, me shumë gjasë, qindra vjet ndërmjet. Sot trajta fonetike e një fjale mund të ndryshojë për shkak të ritmit marramendës të jetës, lëvizjes, urbanizimit, mediaticizimit. Një shndërrim fonetik sot përgjithësohet shpejt në të folmen e bashkësisë, merr trajtë e mund të ngulet edhe për dhjetë a njëzet vjet. Në mesjetë dhe para saj duhej një kohë pakrahasimisht më e gjatë. Kalimi nga njëra trajtë në tjetrën, siç kanë mbetur të ngurtësuar në dy emërvedet - përkatësisht *Vështë* dhe *Vneshtë* - mund të ketë dashtë, mbase, qindra vjet. Gjatë këtyre qindra vjetëve vreshtaria ka qenë gjithnjë shtyllë e ekonomisë vendase. Dëshmitë janë gdhendur te emërvedet.

Si Vneshtat, edhe Kodra e Vneshtës e Vështa, janë shpate me tokë të lehtë dhe rrezina. Domethënë dhë që e rreh rrezja. Në një lartësi që shpalohej ndërmjet treqind dhe pesëqind metra mbi det, shohin me fytyrë kah dielli, nga Lindja e nga Jugu. Fort të përshtatshme me rritë dhe me pjekë rrush.

3.

Cili emërved është më i vjetër, *Vneshtë* apo *Vështë*?

Përgjigja e kësaj pyetjeje, më shumë se çështje e zhvillimit fonetik, është një përgjigje për rrënjët e vreshtarisë në ato anë. Për thellësinë e shtrirjes së tyre në kohë.

Dihet, si *venshtë* ashtu edhe *vështë*, vijonë prej fjalës *venë*.

Vneshtë është përfutur prej *venshtë*, me vendkëmbim (metatezë).

Vështë nuk është përfutur me vendkëmbim, por me përngjashmim (asimilim) të *n*-së.

Trajta *venshtë*, përkatësisht *venshtë*, dëshmohej te Buzuku, te Budi dhe te Bogdani. Ruhet edhe sot në gegnisht. Pra të paktën pesëqind vjetët e fundit është përdorur në vazhdimësi. Edhe *vreshtë* në toskërisht është *venshtë* me rotacizëm, çka rikujton se para rotacizmit në dialektin jugor fjala mbararëbore ka qenë pikërisht *venshtë*.

Duket se arsyeja prin kah përfundimi se trajta *vështë* është më e hershme se *venshtë* (në toskërisht po ashtu krahas *vreshtë* përdoret edhe *vështë*, simotra e *vështë*). Ku mbështetet ky pohim?

Jo vetëm te dëshmitë e shkruara të fjalës *venshtë* (Buzuku, Budi, Bogdani), në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit që shkoi.

Arsyetojmë duke u nisur nga e kundërta.

Nëse paramendojmë se *vështë* është më e re, atëherë del se trajta *venshtë* paskesh "ndërruar mendje", qenkesh rikthyer te forma fillestare *venshtë* për t'u bërë më pas *vështë*. Një udhë që i bie kaq rrotull duke u kthyer mbrapsht, në pikën e fillimit, nuk arsyetohet gjuhësisht. Më e besueshme mbetet mundësia tjetër. *Vështë* është zhvilluar në rrugë të pavarur, duke u nisur edhe ajo nga trajta fillestare e përbashkët *venshtë*.

Është një zhvillim palardhës (paralel), i njëkohshëm, i dy trajtave *vështë* dhe *venshtë*, si degëzime fonetike? Nuk di sa mund të ndodhte një degëzim i tillë i njëkohshëm brenda një fshati, madje brenda një lagjeje të tij, siç është lagjja Elezaj. Dhe a mund të vijonte ky degëzim aty aq gjatë dhe aq kokëfortësisht, sa me mbetet i ngrirë, i ngurtësuar nëpër emërvede: *Vështë*, *Vneshtë* dhe *Kodra e Vneshtës*.

Nëse askjo nuk duket mbushamendëse, sa kohë që s'kemi një hulumtim më të përimtuar, mbetet me besue se këto dy trajta të fjalës nuk janë të njëkohshme. *Vështë* është më e hershme.

Në e marrshim të mirëqenë këtë, mund të pohohet se *vështë* është përdorur para dhe gjatë mesjetës së hershme. Qindra vjet, duke pasur parasysh se në shoqërinë e atëhershme shndërrimi fonetik dhe përgjithësimi i trajtës së një fjale kërkonte kohë të gjatë. Arsyet u shtjelluan më lart.

Gurvarri ilir me gjethet e rrushit e amforën e verës, i qindvjetëshit të parë ose të dytë pas Krishtit; tokat me emrat *Vështë*, *Vneshta*; pylli me gështenja i quajtur *Kodra e Vneshtës* - të tëra këto në një hapësirë jo më shumë se 2-3 kilometra katrore, i lidh një fill i përbashkët të paktën njëmijë e pesëqind vjet i gjatë.

I lidh lulëzimi i pandërprerë i vreshtarisë.

Prapa këtyre emërvedeve ndihet shija e rrushit, erëmiria e vreshtave të mbara, që kanë hijeshuar e pasuruar shpatinat e përdiellura të Malsisë në krahun e djathtë të lumit Valbonë, nëpër qindveçarë.

Prania e vreshtave në këto anë ndeshet edhe nëpër njoftimet e misionarëve katolikë, dërguar Vatikanit nga dioqeza e Pultit. Kur bëjnë fjalë për ekonominë e trevës, për pasuritë e kishës e çështje të jetesës, në mjaft raste përmenden edhe vreshtat. Jo rrallë kokrra e rrushit vezullon si një glob i vogël, në të cilin pasqyrohet bota shqiptare, qysh prej ilirëve.

4.

Prej shumë brezash nuk dëshmohej më vreshta asaj. As në Vneshta, në Kodër të Vneshtës a në Vështë. As përreth truallit ku pronari i Vneshtave, edhe ai me mbiemrin *Vneshta*, gjeti gurvarrin ilir, ndërsa çelte themelet e shtëpisë së re. Rrushi vazhdoi me u mbarështue vetëm në trajtë pjergullash, me shtrat që lëshon hije e ftohtimë (flad) mbi oborret e kullave ose duke u kacavarur nëpër lisa. Pak, kryesisht me u hangër i freskët në familje. Së voni edhe për raki, për përdorim vetjak.

Prej këtu pyetja: për çarsye u bor e u shkretua vreshtaria, aq e lulëzuar në ato troje për qindra vjet?

Arsyeja thotë se heqja dorë nga prodhimi i verës ka çuar te heqja dorë nga mbarështimi i vreshtave. Rakia ende nuk njihet në Arbëri (dokumentohet për herë të parë, tërthorazi, në mesjetë, në një libër taksash në Shkodër, në trajtën *taksë kazani*). Për çka tjetër mund të shërbente asokohe vreshtaria, nëse jo për verë?

Braktisja e prodhimit të verës lidhet para së gjithash me shndërrimin e banorëve të trevës nga të krishterë katolikë në myslimanë. Sipas dokumenteve të botuara, ndërrimi i fesë në Krasniqe, në katundet që shtrihen kryesisht në krahun e djathtë të lumit të Valbonës, ka filluar në gjysmën e dytë të shekullit të tetëmbëdhjetë, pas vitit 1766.

Në rrenimin e vreshtave mund të kenë dorë edhe faktorë biologjikë. Filoksera e hardhisë (*Phylloxera vastatrix*) ka qenë vrasëse e pamëshirshme, murtajë e njëmendtë e rrushit. Në gjysmën e parë të qindvjetëshit të 19-të ka shkumbuar vreshta të pafundme në kontinentin evropian. Mungojnë të dhënat e sakta për dëmet e shkaktuara në hapësirat shqiptare asokohe, por është krejt e qartë se s'kish arsye me i kursye ato. Sipas Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, 2008 (vepër Akademisë së Shkencave të Shqipërisë) edhe në fund të viteve tridhjetë të qindvjetëshit që lame pas, filoksera në Shqipëri ka vrarë rreth njëzet milionë rrënjë hardhi.

Lefter Çipa është emblema e imazhit, Lfuqisë dhe bukurisë që polifonia labe ka përcjellë në kulturën e këngës popullore shqiptare në përgjithësi dhe asaj të Jugut në veçanti. Duke qenë një njohës i thellë e deri në detaje i kësaj kulture të lashtë, poezia e tij ka qenë dhe mbetet një burim autentik i përsëritjes dhe vitalitetit të kësaj tradite përmes një tematike të gjerë sociale, të lirizmit, dashurisë dhe aktualitetit të vazhdueshëm që zbulojnë perlat poetike, në tekstet e këtyre këngëve që thuri gjatë gjithë jetës Lefter Çipa, "Nderi i Kombit".

Në shumë raste, në krijimet e tij pleksen mjaft mirë natyra lirike dhe epizmi i ngjarjeve të shënuara të trevës së Bregut, Himara dhe e gjithë Labëria, ku poeti ka gjetur rastin të shpërfaqë historinë në sinteza të mrekullueshme të kohëve të sotme, ku natyrisht urë lidhjeje mbetet njeriu. I lidhur përjetësisht me këtë marrëdhënie, Lefter Çipa vitalizoi njerëz dhe ngjarje, kohë dhe vende, fshatra dhe zakone të njohura të të gjithë Jugut. Po ashtu, ai mbetet një poet i metaforës së imazhit të historisë, bukurisë dhe mbijetesës, një poet në poezinë e të cilit vibron jeta, nanurisin valët e detit, fryjnë erërat e maleve. Edhe luftërat i zbkurojnë fytyrat e bukura të vajzave dhe grave, të cilat shfaqen herë pas here si një vitalitet dhe domosdoshmëri jetësore, si një dialektikë jetësore, si një burim përmes të cilave rrjedh jeta dhe koha.

Ishte 28 nëntor 2005, kur në qytetin e Vlorës, gratë e shquara shqiptare nga tërë vendi, por edhe nga Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Arbëreshët e Italisë dhe Diaspora në SHBA e Kanada, ishin mbledhur buzë detit në Skelë, në një takim, në nderim të Ditës së Shenjtë të Flamurit. Së bashku me poetin Lefter Çipa, u gjendëm atje, në këtë kuvendim të mrekullueshëm. Të nesërmen në mëngjes, Lefter Çipa më dha në dorëshkrim tri poezi të frymëzimit të tij, të cilat i ruaj si relike mes dorëshkrimeve të tjera.

1. Një nga poezitë më të bukura ku lirizmi, kumti i kohërave, bukuria, hyjniteti, fuqia dhe imazhi shqiptar plekset në imazhin e bukur njerëzor femëror dhe kinematografik njësohen në fytyrën e një artisteje shqiptare, është ajo që poeti Lefter Çipa i ka kushtuar Margarita Xhepës.

Margarita Xhepa mbart në imazhin e saj kohën dhe pamjen e saj, bukurinë dhe identitetin femëror shqiptar, ndërsa si një aktore e përkryer e roleve në kinema dhe teatër, në meditim dhe lirizmin e ngrohtë të poetit Lefter Çipa, ajo duket se i lidh kohët, imazhet hyjnore dhe epike dhe mbi të gjitha, duket se në femroritetin dhe fuqinë që ka krijuar imazhi i saj, sikur janë bërë gjitha perënditë në një.

E zbuluar që nga fuqia e Zeusit, për të bërë Herën (bashkëshortja e Zeusit dhe Perëndia e mbrojtjes së familjes), ajo ngjan të jetë dhe Zhuljeta, të cilën e përshkon një raport i përjetshëm me njerëzit e kohën ("Ti je perëndesha Hera, / Ti je pranvera dhe vera,..." apo "Ike stolitë të gjitha, / Si ishte para Zhuljeta,..."), e parë si diell e hënë, dy simbolet e përjetshëm të bukurisë e shkëlqimit, e ndërsa në të është derdhur gjithë kjo bukuria hyjnore, ajo është një bukuria shqiptare.

Poeti shkruan ndër të tjera: "Te ti tërë perënditë, / Zbresin një herë në ditë, / Ti je princeshë me kurorë, / Supet të mbajnë një shqiponjë", dhe ndërkaq, ajo kthehet në një ndërmjetësim ikonik jo vetëm i bukurisë, por edhe i simbolikave universale hyjnore dhe njerëzore. Diku Çipa thotë për të, se: "Je më shumë se Fatimeja,..." apo "Nëse vetë dhe Shën Mëria, / Po të kishte motër Tya, / S'do të ish mbërthyer Krishti, / S'do të kish lotuar ylli.", madje duke qenë i frymëzuar nga imazhi dhe fuqia që përcjell në kompleks ajo (aktore dhe njeri, bukuria dhe frymëzim që ngjall), i jep asaj fuqinë e një ylli çudibërës, që "... Zgjuan Shqipërinë të gjithë, / Zgjuan dhe Zotin te fronin, / Nga ti lulëzon Tomori!"

Tri poezi me dritë për gratë shqiptare nga Lefter Çipa

Prof. dr. Bardhosh Gaçe

mali i perëndive në Shqipëri.

Dhe pse poezia mbart në indin e saj konceptin e bukurisë femërore, poeti në nënshtresën e përshkrimit të kësaj bukurie, e cila është natyrë, personazh hyjnor, personazh mitik i letërsisë së përbotshme, ajo është autentike shqiptare, e lidhur fort me simbolin e shqiponjës.

Ti je perëndesha Hera

(Margarita Xhepës)

Ti je perëndesha Hera,
Ti je pranvera dhe vera,
Ndaj kish të drejtë Zeusi
Që në dorë i ndizej prushi.

Ti moj ti, moj Margarita
I ke stolitë të gjitha,
Si ishte para Zhuljeta,
Ti moj Margarita Xhepa.

Nëse Hënën lart në qiell,
E ndjek pas vetes një diell,
Brenda shpirtit tënd zbresin
Shpirtin tënd të bukur ndezin.


Te ti tërë perënditë,
Zbresin njëherë në ditë,
Ti je princeshë me kurorë,
Supet të mbajnë një shqiponjë.

Nëse deti ka plot shkumë,
Ti nga deti je më shumë,
Je më shumë se Fatimeja,
Je bota me gjak në deja.

Nëse vetë dhe Shën Mëria
Po të kishte motër Tya,
S'do të ish mbërthyer Krishti,
S'do të kish lotuar ylli.

Ylli yt moj Margaritë,
Zgjuan Shqipërinë të gjithë,
Zgjuan dhe Zotin te fronin,
Nga ti lulëzon Tomori!

Vlorë, 28 nëntor 2005



2. Një refleksion tjetër i kësaj natyre është dhe imazhi peshërendë i një gruaje tjetër ikonike shqiptare, e cila lidhet fort me Shqipërinë, me sakrificën dhe himnin e jetës të mbajtur me luftëra, me lindje dhe vdekje, me të rënë e me epopetë e shënuara nëpër shekujt e pushtimeve të perandorive më të fuqishme të kohërave me të cilat u përball bregdeti shqiptar, por edhe Kanina e Ismail Qemalit.

Poezia "Mbi Kaninë rritet zambaku" i kushtohet Nermin Vlorës, mbesës së Babait të Pavarësisë Ismail Qemalit, të cilin pas vdekjes së tij të mistershme e varrosën në Kaninë. Kanina është një nerv i hershëm lavdie i Bregut dhe Labërisë, i Jugut dhe Shqipërisë, ku në monumentalitetin e pamposhtësisë dhe të mbrojtjes së identitetit të lashtë shqiptar një vend të konsiderueshëm zënë dhe gratë, vajzat e Bregut, të bukura si hyjnitë e të pamposhtura dhe luftëtare si perënditë e luftës, ku shquan Rugjina e Kaninës.

Lefter Çipa ka një gjendje të çuditshme poetike, kur brenda tij lëvizin gjendjet e natyrës njerëzore në momente dhe vende ku historia ka shenjat e saj. Në përfytyrimin dhe në gjendjet e tij poetike njëjtësohet natyra, njerëzit, historia, bukuria dhe simbolika e historisë për të jetësuar një mesazh të rëndësishëm dhe kumt për kohët.

Poezia "Mbi Kaninë rritej zambaku", duke nënkuptuar tipizimin që historia i ka bërë Kaninës, poeti ka përdorur një ritual natyror të ripërtëritjes përmes lules së bukur të zambakut. Nermin Vlora shkon në Kaninë, aty ku babai i saj ka bërë gjumin e rëndë, e toka, natyra, kalaja, malet, deti, gulma e gjakut morën tjetër ritëm. Zambakët e moçëm sikur nga rrënjët kanë biskuar. Poeti përdor mjeshtërisht një personifikim, sikur flasin të gjithë ("Pashë se kjo tokë, Nermin, të ngriti në këmbë..."), flet Ismaili nga thellësia e heshtjes, flet poeti.

Personifikimi që poeti i bën këtij momenti, i lejon atij të bëjë shprehje të gjallërimin, përjetimit dhe të shprehurit të gjithçka i sheh syri dhe i ndjen ndërgjegjja. Mjafton të meditosh mbi strofën e dytë,



ku Çipa shkruan: "E ngrita Nermin, kokën përjetë, / Pashë se deti është bërë fletë-fletë, / Pashë se ty Nermin, t'u hapën sytë, / Pashë se lule të sillnin Perënditë.". Më pas përfytyrimi dhe simbolika e historisë dhe përjetësisë vjen përmes "valëvitej Flamuri", ku dhe gurët këndonin për këtë ditë, sikur nëpër kohë vinte Donika (kjo grua epike e historisë së hershme shqiptare), ndërsa Babai i Pavarësisë bënte kuvend burrash me Çikën, malin që kishte parë luftëra, njerëz dhe histori.

Strofa: "Unë me një qiri të ndezur në dorë, / Të thashë, fli gjumë, fli moj Zonjë, / Se për gjumin tënd rri në këmbë një Vlorë, / Që është Romë e përmbi Romë," përcor një merak të përjetshëm shqiptar, lidhjen e fortë me tokën e të parëve, e skalitit fort në gjithë traditën arbëreshe, që poeti Çipa e sjell përmes një raporti të shumëfishtë, të qetësisë të shpirtit të Ismail Qemalit mbi fatin e Atdheut e Kombit, kumtin e të cilit mund ta përcjellë veç Nermini, e meraku i Nermin Vlorës në amanetin e gjyshit, për të cilin s'e ka bërë gjumin e qetë, të nderimit që Vlora dhe shqiptarët kanë dhe do të kenë për veprën e pavdekshme të Ismail Qemalit. Prandaj poeti i këndon dëshirës për ta bërë gjumin e qetë në Vlorë Nermin Vlora, që është "Romë e përmbi Romë!", se "Këtu në Vlorë, çlodhen dhe Perënditë...".

Poezia kushtuar gruas më me peshë në krenarinë e kombit është një poezi e natyrës lirike, por e mbartur fort mbi elementë epikë-historikë, përmes kronikave të Kaninës dhe Vlorës, veçmas të figurës historike të Ismail Qemalit nën dekorin e maleve dhe pasqyrën me dallgë e valë të detit.

Mbi Kaninë rritej zambaku

Të erdha sot, atje ku bën gjumin e rëndë,
Pashë se kjo tokë, Nermin, të ngriti në këmbë,
Dhe vërtet Nermin, mua m'u ndez gjaku,
Kur vërtet mbi Kaninë, rritej zambaku.

E ngrita Nermin, kokën përjetë,
Pashë se deti është bërë fletë-fletë,
Pashë se ty Nermin, t'u hapën sytë,
Pashë se lule të sillnin Perënditë.

Ty, përsipër ballit të valëvitej Flamuri,
Dëgjova vërtet, se këndonte vetë guri,
Aty m'u kujtua dhe pashë Donikën,
Pashë Ismail Qemalin, që bisedonte me Çikën.

Unë me një qiri të ndezur në dorë,
Të thashë, fli gjumë, fli moj Zonjë,
Se për gjumin tënd rri në këmbë një Vlorë,
Që është Romë e përmbi Romë.

Bën Nermin, gjumin e Evgjenisë,
Brenda zjarrit dhe gjirit të Shqipërisë,
Këtu në Vlorë, çlodhen dhe Perënditë,
Ku kanë fronin, vërtet tërë Hyjnitë...

Vlorë, 28 nëntor 2005

3. Një profil tjetër i femrës shqiptare, ku mbartet fuqishëm kumti i lashtësisë me bukurinë e femrës është poezia “Hënë e bukur për të tërë”, ku siç dhe mund të kuptohet, bukuria e artistes Luiza Laska, e tejkalon kufirin, është gati hyjnore, për shkak të krahasimit dhe ngjashmërive që poeti gjen tek ajo. Është një bukuri për të tërë, një përgjithësim i konceptit shqiptar, pra një hënë shqiptarie.

Ndryshe dy profileve të mëparshme, në këtë rast Çipa e zbulon femrën shqiptare përmes rrugëtimit në profilin e saj, si një artiste, duke kënduar këngën qytetare korçare (“... Nisja këngës shqiptare./Me melodinë tënde korçare.”; si një model i përkryer i dashurisë së shenjtëruar (“... Moj artistja, Zonjë Arbërore./ Zonjë e Madhe, Zonjë Vlore.”).

Çipa ka një ndjesi hyjnore, një përçim të shenjtë të lidhjes që arti dhe artistja u bën kohëve në artin e skenës apo kinemasë, ndërsa ato shkëlqejnë në revokimin e kohëve, në fakt bëhen një të kohëve, strofa: “Ti kishe lindur për skenë./ Për të luajtur Ervehenë./ Njëpër dramën Shekspiriane./ Ngjall të vdekurit e mbyll varre./ Ti gazmon të gjallët./ Dhe na mban gjallë të parët.”, e ndërsa përmes profilin të saj poeti kujton suljotët, genin e mrekullueshëm shqiptar, nuk harron ta shohë atë në kumtin dhe simbolin hyjnor të hënës, pasi hëna zakonisht është poezi dhe grua, ai shkruan: “... Moj Lizë, ty t’u ngjatë jeta./ Paç jetë të gjatë si hëna./ Sepse hënë vërtet ke qenë./ Hënë e bukur, e pangrënë!”.

Në poezitë që marrin shkas nga profilet femërore të Leter Çipës ka një mishërim unik të natyrës dhe të detajeve historike, që i bëjnë ato profile të qëndrueshme jo vetëm të natyrës lirike, të imazhit e bukurisë, por edhe të një epizmi historik.

Përmes një stili të thjeshtë, i cili ishte në natyrën e lëvrimin të poezisë, por edhe të thurjes së këngës polifonike, një zhanër mjaft komunikues përmes shfaqjes së tipareve dhe cilësive, Çipa përcjell gjendje shpirtërore të epërme dhe emocione të karakterit të ndjeshëm shqiptar, veçmas së traditës së Bregut, ku shquajnë temperamentet e dukshme burrërore dhe lirizmi i ngrohtë femëror.

Hënë e bukur për të tërë

Dil moj Luiza në dritore,
Dil moj dil, si një vitore,
Nis një këngë, këngë korçare,
Njëpër erë të hollë bore,
Nisja këngës shqiptare,
Me melodinë tënde korçare.

Mos e harro dashurinë,
Dashurinë e shenjtëruar,
Mbaje në zemër si dritë,
Moj Artistja e Nderuar.
Moj artistja, Zonjë Arbërore,
Zonjë e Madhe, Zonjë Vlore.

Ti kishe lindur për skenë,
Për të luajtur Ervehenë,
Njëpër dramën Shekspiriane,
Ngjall të vdekurit e mbyll varre.
Ti i gazmon të gjallët.
Dhe na mban gjallë të parët.

Liza më dukej suljote,
Po moj po, për Perëndi,
Se ti je tua prej molle
Me një shpirt vërtet magji.
Ti je magjia e jetës,
Po dhe mjalti, mjalti i bletës.

Ndaj në letër më shket pena,
Dhe shkruan mbi zemrën tënde,
Moj Lizë, ty t’u ngjatë jeta,
Paç jetë të gjatë sa hëna,
Sepse hënë, vërtet ke qenë,
Hënë e bukur, e pangrënë!

Vlorë, 28 nëntor 2005.

Libri me poezi i Mero Bazes, “Shi me baltë”

DIMENSIONI I DHEMBSHURISË DHE HUMANIZMIT NË POEZINË E MERO BAZES

Nga Leonidha Mërtiri

Pasi lexon librin me poezi “Shi me baltë” të Mero Bazes, provon një ndjesi të çuditshme që të shoqëron ngrohtësisht dhe nuk të lë pa iu kthyer me të njëjtën dëshirë këtyre poezive përsëri. Dhe kjo ka arsye të veta. Sepse trupi i secilës prej tyre është skalitur me një ngrohtësi të rrallë, që buron natyrshëm në tërë qënien e vetë nga gjithçka e përjetuar.

Publicisti dhe gazetari i njohur Mero Baze, i dashur dhe i kërkuar nga lexuesi për editorialet e përditshme dhe shkrime të tjera, na befason këtë radhë dhe me poezitë e veta, të mbledhura me kujdes në “Shi me baltë”. Autori i poezive të hershme, si gjimnazist dhe student, botuar në gazetën “Studenti” dhe “Zëri

i Rinisë” apo në librin e viteve të shkuar “Jug”, tani vjen me këtë libër dinjitoz, ku çdo varg e strofë të futin në një botë të shumëdëshiruar, poezi të vërteta nga një zë i veçantë, që i jep impulse reale poezisë sonë.

Pas kësaj, pyetja legjitime: Përse iu vonuan ato lexuesit, në këtë heshtje të gjatë, teksa qëndronin në habitatin e tyre? Kështu, publicistika e Mero Bazes ka qënë pranë e pranë poezisë që prushëronte për të dalë në dritë denjësisht këto ditë, për ta shijuar me tërë forcën këto dhuratë të mrekullueshme që i bëhet lexuesit. Ndërkohë, kemi të drejtë të pohojmë, se kjo befasi e bukur na shton optimizmin për poezinë e sotme shqipe, por dhe për



atë që “Shi me baltë” radhitet me dinjitet krahas tyre të poetëve më në zë, në fondin më të mirë të poezisë së sotme shqipe. Dhe pse ka poezi të shkruara në vite, ato vinë të freskëta, natyrshëm, me sensibilitet të admirueshëm.


Pa u ndalur në vlerat reale të gjithanshme të librit, për të cilat me të drejtë është folur dhe shkruar, po i qëndroj një fakti tepër të rëndësishëm: Në të katër ciklet e librit ndihet një shpirt tepër i dhembshur, dhembshuri që bie në sy dhe bëhet objekt i këtyre mbresave, ku po ndalem shkurt dhe ku dashuria për Atdheun, për njerëzit e tij është majaja e mbrujtur në këto poezi.

Publicisti, gazetari Mero Baze, që fshikullon me editorialet, shkrimet e veta anëtar negative në jetën tonë të përditshme, aferat e ndryshme kudo dhe te kushdo që shfaqen apo lartëson e promovon ato çka vendin tonë e rritin, në poezitë e tij ndjen dhembjen e thellë për braktisjen e fshatit të vetë, të vendit në tërësi, me dashurinë e madhe për ta. Jugu i bukur, por mbetur pa njerëz. Atdheun, me të cilin Mero Baze është lidhur pazgjidhmërisht, ndryshe nga të tjerët, duke ia ndërë nga afër pulsën në çdo hap, nuk e idealizon atë, por jep frymëmarrjen reale të tij në rrugën e tranzicionit. Të prekshëm kjo dhembje që dhemb dhe ky shqetësim tek sheh që “...Atdheu rritet pa pasur të vegjël/, Ngre shtëpi si prind me shumë fëmijë./Edhe pse vatrat bosh kanë mbetur/,Dhe askush s’e di kush do rrijë...”. Apo tek sheh portat e mbetura pa shtëpi, ndërsa, siç thotë poeti,“...rri vras mendjen, si është e mundur/, që portat e drunjta mbijetojnë si hekur/, dhe oxhakët rrinë-kokalla mbi gërmadha/, të vetmet gjymtyrë të kufomës pa tretur/. Dhe më tej tabloja ndriçohet qartazi dhe ndjen tonet optimiste përmes një figuracioni ekselent kur autori thotë se “...kuptoj pak nga pak kush vdes në fund/, kur vdekja merr vërtetë një jetë, një njeri/, portat ruajnë skeletin e jetës së fikur/, oxhakët shpresën të ndizen përsëri”.

Tronditëse dhe dallgë të forta emocionale sjellin poezitë për humbjen e njerëzve të dashur, të nënës dhe babait, por dhe të shokëve dhe miqve, të bashkëfshatarëve. Kuptohet. Këto poezi nuk mund të mos ishin fryt i një shpirti të ndjeshëm. Njerëzor, ku humanizmi ndërthehet organikisht. Pas kësaj, dhe shpirt të gurtë të kesh, lexuesi nuk mund të mos përfshihet nga një përjetim i thellë.

Kështu, libri flet për pjekurinë artistike të autorit, si mjeshtër i fjalës dhe vargut të rimuar, i përdorimit të figurave letrare, sidomos metaforës, por dhe krahasimit, aliteracionit etj, duke i dhënë poezisë së tij të shumëpritur origjinalitet të veçantë.

Duke përsëritur vlerësimin e poetit të njohur Ilirian Zhupa, bashkohem me bindjen, se “pavarësisht nga zejet e shumta, me fjalën që ushtron, poezia është dhe mbetet për Mero Bazen “thembra e Akilit”. Një poezi e vërtetë.



E vërteta është se deri para disa kohe, sa herë përmendeshin arbëreshët e Italisë, në përgjithësi, na ishte krijuar mendimi se ata fill pas vdekjes së Heroit tonë të madh Skënderbeut, për t'iu shmangur raprezaljeve dhe hakmarrjes të hordhive turke, ua hipën anijeve dhe u dyndën drejt bregut tjetër, ku gjetën mikpritje dhe paqen e nevojshme. Po ashtu dimë se ata ruajtën gjuhën, doket, zakonet, veshjet, folklorin dhe sidomos mallin për atdheun e të parëve për shekuj të tërë. Po ashtu, sidomos nga mesi i shekullit të XIX - të dolën një aradhë intelektualësh, kryesisht shkrimtarë e poetë që me veprën e tyre, jo vetëm e rizgjuar dashurinë për Shqipërinë, por edhe i paraprinë Rilindjes sonë kombëtare. Kjo njohje e cunguar, ndofta ka ardhur edhe nga mangësitë e informacioneve serioze, nga mosmjaftueshmëria e botimeve dhe kontaktet e pakta që kemi pasur me arbëreshët. Por, ja ku na vjen një libër studimor i plotë, prej mbi 900 faqesh, që dikush me të drejtë e ka quajtur enciklopedi, i shkruar nga i mirënjohuri Fatmir Toçi dhe i botuar nga Toena, në hyrje të të cilit shkruhet: "Arbëreshëve të Italisë, për historinë e tyre të dhimbshme të mbijetesës dhe krenarinë për prejardhjen arbërore, që na jep dinjitet si komb e na bën t' i duam e t' i çmojmë, por, para së gjithash, t' i njohim më mirë". Nuk mund të flasësh për këtë libër, pa kujtuar me respekt të veçantë përpjekjet e jashtëzakonshme që ka bërë autori i tij për vite me radhë, duke rëmur nëpër arkiva, duke vizituar thesare shkrimore të pluhurosura kishash, kryesisht ato që vijojnë traditën bizantine, duke gjetur e shfletuar pa fund libra të kësaj teme nga autorë të ndryshëm, duke shkelur vetë çdo trevë ku arbëreshët kanë qenë ngulur apo vijojnë të jetojnë dhe jo vetëm në jugë të atij vendi por, edhe në ishuj, si fjala vjen në Sicili e Korsikë, apo në veri, duke marrë kontakte me njerëz të politikës, kulturës, arteve e deri atyre të zakonshmeve, gjë që do të qe një ndërmarrje aspak e lehtë edhe për vetë Akademinë tonë të Shkencave. Dhe si rezultat i gjithë kësaj pune, del që "Lëvizjet në masë e shqiptarëve drejt brigjeve italice kanë filluar pas fushatës ushtarake së vitit 1336 të Perandorisë Bizantine, në bashkëpunim me serbët e Stefan Dushanit, për shtypjen e revoltave popullore". Dhe ishte kjo periudhë që i parapriu atij eksodit biblik të shekullit të XV - të dhe që vijoi edhe më vonë në kushte, forma dhe përmasa të tjera, pasojë e fatit tonë të keq që na kishte rezervuar padrejtësisht historia. Por duhet pasur parasysh se emigrimi i fazës së dytë dhe të tretë favorizoheshin edhe nga disa rrethana, si fjala vjen; aleanca e Gjergj Kastriotit dhe ndihma që ai i dha Alfonsit të Parë të Napolit në shpyjën e rebelimit të baronëve të Kalabrisë dhe vendosjen si shpërblim të familjeve të ushtarëve shqiptarë atje, e pastaj, përkrahja nga djali i tij Ferdinandit. Nga libri mësojmë edhe për familje e qytetit tonë, Durrësit që u vendosën atje. Kështu, familja e Gjon Durrësit (Giorgio Durazzo), qysh në vitin 1387 shkon në Gjenovë, ku merren me tregti, përpunim lëkurësh dhe transaksione financiare. Pasi u konsolidua dhe fitoi një reputacion mjaft të mirë, nga kjo familje kanë dalë nëntë kryeministra të Gjenovës që aso kohe quheshin doxhë, tridhjetë senatorë, dy kardinalë, pesë peshkopë, gjashtëmbëdhjetë ambasadorë e plot burra të shquar në fusha të nga më të ndryshmet. Por pati edhe disa faktorë të tjerë që kushtëzuan edhe lëvizje të fiseve apo kolonive shqiptare, pra migrimin e tyre në treva të tjera brenda Italisë, pasi fjala vjen, dihet se Sicilia dhe Kalabria janë quajtur "Terra ballerina" pra "Toka Valltare" për shkak të tërmeteve të fuqishme. Kështu kujtojmë se si pasojë e këtyre goditjeve erdhi boshatisja nga banorët autoktonë pas viteve 1693, 1783 apo 1909 ku gjetën vdekjen qindra mijra banorë të cilët duheshin zëvendësuar edhe si krahë

Mbi librin "Arbëreshët, shqiptarët e Italisë"

ARBËRESHËT, SI I PA DHE SI I NJOHU FATMIR TOÇI


Nga Shpendi Topollaj

pune. Për më tepër, arbëreshëve iu dha leja e organizimit dhe për këtë u caktuan sipas rasti edhe ata më të shquarit që kishin dhënë edhe prova trimërie e besnikësie, si feudali i fuqishëm Dhimitër Kapucimati e Llazar Mate, kalorësi stratiot që me 300 ushtarët e tij kishte fituar simpatinë e mbretit Ferdinand. Mjafton të kujtojmë referimin e autorit te prof. Jose Floristan edhe për prurjen nga Peloponezi të rreth 8000 vetëve, shumica arvanitas nga ana e admiralit emërmadh Andea Doria në Napoli e Mesinë apo faktin që edhe sot e kësaj dite një lagje në Taorminë në provincën e Agrixhentos vazhdon të quhet "Lagja e shqiptarëve". Dhe kudo që shkuan, arbëreshët me punën e tyre të ndershme, ditën të përshtaten dhe të ndërtojnë me dinjitet jetesën e tyre. Në gjysmën e dytë të shek. të XVII - të, 700 emigrantë shqiptarë, vetëm brenda një viti, pasi zbankuan në Korsikë mes shumë vështirësive, arritën të ngrenë fshatrat Pankone, Korona, Rondolina, Saliçi dhe Monte Rose dhe më pas edhe një kishë, çka i bëri shembull edhe për vetë popullsinë vendase. Por historia pranon vetëm të vërtetat, prandaj Fatmir Toçi nuk ngurron të na tregojë se nga popullsia vendase ka pasur edhe reagime për të mos i pranuar të ardhurit, si ai i banorëve dhe klerit të qytetit të Bozës apo ata të Sant Antiokos. Një vend të rëndësishëm zë në këtë libër përshkrimi i fatit të familjeve të mëdha që u larguan nga atdheu pas pushtimit turk si Kastriotët, Muzakët, Arianitët, Zenebishtët, Matrangët, Skurajt, Topiajt, Buat, Shpatajt, Gropajt, Dukagjinët, Spanët, Engjëjt, Drishtit etj. Natyrisht që kurreshtja jonë përqendrohet

te gruaja e heroit, Donika dhe pinjollët e Kastriotëve pas rënies së Shkodrës që sqarohen fare mirë nga autori i cili u referohet autoriteteve studimore si Paolo Petta dhe Domenico De Filippis. Ndër të tjera del edhe figura e Gjonit Kastriotit i vendosur në Napoli dhe i shquar në luftime kundër turqve, venecianëve dhe francezëve i cili u martuar me Irenë Brankoviçin, vajzën e despotit Llazar të Serbisë me të cilën patën pesë fëmijë, ku veç Ferdinandit dhe Gjergjit të suksesshëm, u dallua Maria për kulturën e saj të spikatur në atë kohë dhe që u bë edhe engjëlli mbrojtës i arbëreshëve. Fatmiri, duke i kushtuar rëndësinë e duhur ruajtjes së gjuhës nga arbëreshët, thotë se rol të madh në këtë drejtim ka luajtur feja ortodokse që ata mbrojtën nën juridiksionin e Vatikanit, ku spikati Papa me origjinë shqiptarë Klementi i XI - të që qëndroi në atë detyrë për 21 vjet dhe dha një ndihmesë të konsiderueshme për vendin tonë dhe pas tij Lorenzo Orsini, Papa Klementi i XII - të dhe Benedikti i XV - të në vitin 1919. Ndaj nuk është për t' u habitur përse nga 91 kisha të rritit bizantin edhe pse ka kaluar një kohë kaq e gjatë, 26 prej tyre edhe tani i kryejnë shërbesat sipas traditës. Autori Toçi thekson se "Për Shqipërinë, kultura dhe gjuha arbëreshe janë një pasuri shumë e vyer kombëtare", ku natyrisht ka dhe dallime pasi arbërishtja ka italianizma, sikurse shqipja nuk u ka shpëtuar turqizimeve. Edhe pse, arbëreshi me shqiptarin mund të kuptohen fare mirë. Patjetër që rol të pamohueshëm në ruajtjen e gjuhës, ka luajtur çelja e shkollave dhe e kolegjeve si manastiri bazilian i Munxifit, "Korsini", "Shën Adriani", "Shën Mërisë" etj. ku meritë



kishin dy herë ish kryeministri i Italisë me origjinë shqiptarë Françesko Krispi, Gjergj Guxeta, Antonio Brankatos me shokë. Kjo bëri që të dalin nga gjiri i popullit arbëresh një plejadë intelektualësh e shkrimtarësh atdhetarë tashmë të njohur prej nesh si Gavril Dara i Riu, Jeronim de Rada, Zef Skiroi, Jul Variboba, Dhimitër Kamarda, Anton Skura, Françesk Santori, Vinçenc Stratigoi etj. etj. që me gazetat dhe veprat e tyre jo vetëm ndriçuan realitetet politiko - sociale të arbëreshëve dhe nxitën kulturën rilindase shqiptare, por dhe shërbyen si iluministë të botkuptimit të popullit tonë për liri e pavarësi dhe sikurse shprehet autori "e ngjallën dhe i dhanë shtytë çështjes shqiptare, duke ndihmuar në njohjen e saj botërisht". Në historinë e letërsisë tonë nuk harrohet ajo që bëri Jeronim De Rada me gazetën e tij "L' Albanese d' Italia" dhe më pas me revistën "Fjamuri i Arbërit" dhe lidhjet e tij me burra atdhetarë si Naim e Sami Frashëri, Thimi Mitko, Dora d' Istria, Zef Jubani etj. Më tej ky libër voluminoz vijon me përshkrime, mbresa, të dhëna historike, gjeografike, turistike, kulturore, folklorike, fetare, arsimore, muzeale, objekte kulti, shoqëruar me një mori hartash, toponimesh, referencash dhe fotografishë etj. për plot 18 Krahina dhe 114 Provinca ku jetojnë arbëreshët e Italisë, çka flet për një punë mëse të lavdërueshme atdhetare të politikanit të mençur dhe të ekuilibruar Fatmir Toçi i cili me një vepër të tillë, ndofta të pashoqe, jep shembullin se si me vullnet, urtësi, thjeshtësi, sakrificë dhe mbi të gjitha me ndershmëri, mund t' i bësh vendit dhe popullit tënd shërbime të çmuara dhe të meritosh mirënjohjen e përherëshme të tij.



Piktura nga Pashk Përvathi

“Realiteti” artistik kutelian - përgjigje groteske dhe karnavaleske ndaj trashëgimisë historike

Te forma narrative e *rrëfimit* kutelian gjendet një hapësirë kolektive tek e cila, ashtu si përreth vatrës, narratori u tregon me zë rrëfimndjekësve. Kjo hapësirë publike është popullore, është si hapësira e një sheshi.

Ky *rrëfim* i merr elementet, strukturat dhe motivet, shpesh nga përralla: koha sikur mbetet pezull në një kategori aspak konvencionale, koordinatat hapësinore janë të anuluar, kufiri mes reales dhe fantastikes është fshirë. Është kjo mënyra që lejon, gjithashtu, prani të tjera, të një bote tjetër. Kuteli me *rrëfimin* e tij thekson përmasat groteske, të pranishme në tregimin përrallor; tekstet e tij bëhen në të njëjtën kohë enëmbajtëse anomalish të një bote të përmbysur në krahasim me botën e realitetit dhe të konvencionit: një botë johistorike, nga e cila del, gjithsesi, në sipërfaqe mundësia e një rilindeje, e një fillimi. *Rrëfimi* kutelian na paraqitet si një procedim narrativ pranë logjikës së karnavales siç është përshkruar nga Bachtin-i.

Zbrazëtia historike e Shqipërisë në fillim të shekullit mund të harrohej dhe përballohej nëse i jepeje drejta e qytetarisë në brendi të hapësirës artistike të *rrëfimit*. Kuteli nuk “përdor” të kaluarën historike si garanci për të ardhmen. Në të kundërt, qëndrimi ideologjik kutelian, është qëndrimi i një intelektualit që propozon “rinisjen nga fillimi”, nga e tashmja.

Rrëfimi e përmbys në mënyrë të ndërgjegjshme historinë dhe e filtron nëpërmjet këndit pamor të protagonistit të tij kryesor, popullit, duke e shndërruar atë në zëdhënës të ndërgjegjes së tij.

Kjo teknikë narrative, që arrin të shndërrojë përditshmërinë në objekt të një shtrembërimi të jashtëzakonshëm dhe grotesk, karakterizohet, sipas Bachtin-it, nga “një sentiment karnavalesk ndaj botës”, që është një ndjenjë që vë «imazhin dhe fjalën e tyre në një raport të veçantë me realitetin».¹

Ashtu si gjatë karnavaleve u jepet hapësirë e plotë shfaqjeve që gjatë gjithë vitit nuk kanë të drejtën e qytetarisë, edhe vepra e Kutelit, “detajet artistike” që në përditshmërinë e jetës njerëzore do të zinin përmasa të vogla, i shndërron në elemente që mbushin të gjithë hapësirën narrative të krijimit.

Hapësira artistike është plotësisht e zënë, edhe si kohë e narracionit, edhe si hapësirë reale gjeografike me spektakle sinkretike të karakterit ritual.

Në rrëfimet kuteliane, përmbysja karnavaleske e botës përfundon në një vizion të efektshëm mbi ekzistencën e pandryshueshme të njeriut shqiptar, sidomos të njeriut bashkëkohor, të paraqitur në përmasa groteske para syve modernë.

Jeta e karnavalizuar, e nënkuptuar si një “botë e përmbysur”, e rrotulluar për së gjeri e për së gjati, kthyer drejt “vetes dhe drejt lexuesit”², shërben për të kuptuar

¹ MICHAEL BACHTIN, *Problemy poetiki Dostoevskogo*, përkth. it. *Dostoevskij. Poetica e stilistica*, Torino, Einaudi 1968, f. 140.

- Shih edhe MICHAEL BACHTIN *Tvorëstvò Fransua Rable i narodnaja kul'tura srednevekov'ja i Renessansa* 1965, përkth. it. *L'opera di Rabelais e lacultura popolare. Riso, carnevale e festa nella tradizione medievale e rinascimentale*, Torino, Einaudi 1979.

² Po aty, f. 228.

Titulli është redaksional. Marrë nga libri “Pamje të modernitetit në letërsinë shqipe: Proza e shkurtër e Koliqit, Kutelit dhe Migjenit”, Onufri 2004, fq. 93-102

RECEPTIMI I PROCEDIMEVE NARRATIVE TË GOGOLIT DHE TURGENIEVIT NË RRËFIMIN E KUTELIT

Nga Prof. Dr. Blerina Suta

më mirë dhe në mënyrë më të plotë kompleksitetin e saj:

«Karnavalja afron, bashkon, ndërlidh dhe kombinon të shenjtën dhe profanen, sublimen dhe intimen, madhështoren dhe meskinen, të urtën dhe marrinë, dhe kështu me radhë.»³

Karnavaleskja lejon të «zbulohen» anët më të fshehta të natyrës njerëzore; duke u bërë një «gjuhë e veçantë» ajo zotëron një «forcë të jashtëzakonshme përgjithësimi në thellësi».⁴

Në raportin mes formuluesit

³ MICHAEL BACHTIN, *Dostoevskij*, vep. e cituar, f. 160.

⁴ Po aty, f. 205

(enunciatorit) dhe lokutorit (subjektit që flet), referimet e kohës dhe të vendit, i përkasin lokutorit. Ndërsa, në rastin kur formuluesi (enunciator) merr pozicionet e “këndvështrimeve të ndryshme”, ai i vë ato në “përballje dhe fërkim”, me “efekte për më tepër ironike dhe çmitizuese”.⁵

Marrëdhënia e gjinive (ashtu si *rrëfimi*), që përdorin komiken ose grotesken si ind të formës së organizimit artistik me traditën është, sipas Bachtin-it, «thellësisht kritik, dhe ndonjëherë cinik, demaskues» duke u bazuar «në mënyrë të ndërgjegjshme mbi përvojën dhe trillimin e lirë». Situata shqiptare mes dy

⁵ CESARE SEGRE, *Intreci di voci...*, vep. e cituar, f. 5.

luftërave karakterizohet nga një hendek dhe zbrazëti. Prandaj, Kuteli krijonte situata të jashtëzakonshme për të zbuluar shtresat më të thella të personalitetit dhe të mendimit shqiptar.

Forma e *rrëfimit* kutelian, duke u karakterizuar nga mungesa e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të intelektualit-shkrimtar në narracion dhe nga dialogu i drejtpërdrejtë me realitetin njerëzor shqiptar, filtrohet në ndjeshmërinë dhe në gjuhën e njeriut-narrator popullor. Zbrazëtia e periudhës historike të tranzicionit bëhet burim detajesh groteske. Shprehjet anormale të jetës mbushin të gjithë hapësirën skenike të *rrëfimit*.

Kuteli ngre para syve tanë një realitet të pagjasës, duke e shndërruar në një mjet për të bërë propozime etiko-morale. *Lugetërit e fshatit tonë* është një *rrëfim*, ku përdoret në mënyrë të shkëlqyer teknika karnavaleske. E pagjasa bëhet simbol i jetës bashkëkohore. Jeta e përditshme sillet te veprimi i ndërthurjes së karnavalizuar, e zakonshmja dhe e pandryshueshmja ndërthuren me të jashtëzakonshmen dhe të ndryshueshmen.⁶ Jeta shpirtërore shqiptare, e zhveshur në periudhën e tranzicionit dhe të ngjarjeve historike të fundit të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX, duket sikur është kthyer prapa, sikur është bërë shprehje e një prapambetjeje origjinare. Këtu merret shkas për “moralin” e nevojës së një jete të re intelektuale.

Universi i ri i shoqërisë shqiptare kishte nevojë për një rregull të ri, sipas një parimi të ri në përputhje me natyrën “e vërtetë të shqiptarit”. Arketipi ritual i raportit botë njerëzore - lugetër paraqitet në një dritë të re, në dritën e estetikës së groteskes, që kujton fëmijërinë e njeriut ku supersticionet ishin pjesë e “shenjtë” e jetës së tij.

Në rrëfimet *Letrat e ndajnatës* dhe *Lugetërit e fshatit tonë* krijohet skena e tërësisë karnavaleske; i gjithë fshati merret me lugetërit, sikur niveli i jetës mendore të shoqërisë të ish paralizuar:

«Shok-o, nuk di fshatrat e tjera, po fshati ynë është rëngë me lugetër. Nuk ka pranverë e verë që të mos ngjallen nga dy a tre.»⁷

Përfshirja e lugetërve në jetën e të gjallëve, disa të këqinj dhe disa të mirë, situata rituale të luftës kundër shpirtëve të këqinj, sjellin ngjyrën e një Shqipërie rustike, të zhveshur aty për aty nga shprehjet më domethënëse të jetës së saj shpirtërore. Supersticionet rustike, të jetuara si “të vërteta” nga të gjithë anëtarët e bashkësisë, janë të përhapura në krejt hapësirën artistike të veprës. Kjo teknikë thekson nivelin e ulët të jetës shpirtërore në periudhën historike të tranzicionit dhe nevojën për të rivendosur cilësitë më të mira të identitetit shqiptar.

Këto detaje invariante karnavaleske gjenden shpesh me ngjashmëri të habitshme në krijimtarinë e Turgenievit dhe Gogolit. Është fjala për dy tregime: përkatësisht *Luadhi i Biezhës*⁸ i


⁶ MICHAEL BACHTIN, *Dostoevskij...*, vep. e cituar, f. 207: “[...] Gjëja më e qenësishme e këtyre romaneve është përdorimi i karnavaleskes për të pasqyruar realitetin bashkëkohor dhe mënyrën e jetesës bashkëkohore”.

⁷ MITRUSH KUTELI, “Letrat e ndajnatës- Lugetërit e fshatit tonë”, *Netë shqiptare*, Tiranë, Shtypshkronja e Shtetit 1944, f. 133.

⁸ IVAN S. TURGENIEV, “Luadhi i Biezhës”, *Zapiski ohotnika / Kujtimet e një gjahtarit*, përkth. nga origjinali

Blerina Suta

PAMJE TË MODERNITETIT NË LETËRSINË SHQIPE



Onufri
30 TIME

1 - Perënditë ikën ...

Nuk dihet pse perënditë u mërzitën dhe krijuan Njeriun.
U mërzitën keqas përsëri,
dhe shpikën dashurinë.

Mërzia pas kësaj, u tha: mori fund,
dhe perënditë ikën.

Eshtë më e lehtë të ikësh
apo jo?

Njeriu mbeti fillikat
mbështetur pemës së vetme
në mes të fushës,
teksa vetëtimat fshikullonin tokën.

Ajo që shihte natën
duke depërtuar muret,
sigurisht nuk ishte ajo
që shfaqej ditën ...

2 - Djeg veten ...

Plagë të kuqe, vrima zjarri dhe uri të
heshtur,
me kall në gjak, pak e pak,
të mos rrëzohem.
Ti je si uji i ftohtë për shkretëtirën,
Djeg veten që unë të mos ftohem.

Falemi - kryqëzohemi,
lëmë gjurmë ngazëllimi
moj grua e dashur,
gjithë natën.
Në kishën tonë të përbashkët.

Përrallë e ngjashme
me djegën e epshit,
Përrallore,
ëndërr - shtegëtim,
A nuk kemi brenda vetes gjithësinë?

Digjemi e digjemi,
dhe hiri i bekuar bëhet polen,
petëlat janë qielli, fluturimi.
Në ne ose askund, gjenden përherë,
botërat dhe amëshimi!

Vizatojmë shenja e hieroglifë buzësh,
mbi vijën e lakuar të qafës, e belit,
ti e di është sekret i përveçëm,
ky triumf i natyrës mbi rregullin.

Plagë të kuqe, vrima zjarri dhe uri të
heshtur,
më kall në gjak, pak e pak,
të mos largohem.
Je si uji i ftohtë për shkretëtirën,
Djeg veten që unë të mos ftohem...

3- Ujk i zi në dëborën e bardhë ...

Një ujk i zi vjen rrotull, nëpër dëborën e
bardhë,
Mjegull e keqe, llurbë, mahi tinzare, ç'të
hajë?

Kërkon shteg hileqar, ngrehën që ra e u
shëmb,
Kurthëruar, fikur, urritur prej boshit që
çmënd.

Dhemb stomaku, ulërin britma, instikti
nuk humb,
Shuar, shterur, gremisur përthellë, në
shkrumb.

Humbje përzhitur, dhëmbë që presin, huti
rituali,
Fund i rrëfimit pa fund, heshtak, vdekur i
gjalli.

Tërbuar e truar bisha, teknikë inverse dhe
gjak,
Gjërë gjah harresash - dëshmia e rrëfimit
opak.

Plojë, mite e kohë, që ecin kuturu dhe

ODISE KOTE**Heshtja***Poezi*

mbrapsht,
Shkrepëtimat në sy rrinë pezull, sqimë e
after life.

Një ujk i zi vjen rrotull, nëpër dëborën e
bardhë,
Bota feston mbi gërmadha, llurbë e marri,
ç'të hajë?

4 - Sepse në thelb ...

Asgjë nuk na është falur, shputat e këmbëve
janë vija - vija,
nga gjurmët në tokën çarë thela - thela
prej thatësirës e vuajtjes.
Kemi firmosur një kontratë me shpirtin të
mos dorezohemi,
e dimë që lindim e vdesim tek gjuha, atdheu
ynë i vërtetë.

Shpesh eh, drita nuk bie siç e do zakoni
mbi përmbajtjen,
duke humbur kuptimin e krijimit, (blasfemi
liliputësh).
Të degdisur vendeve të errëta, në rrëpira
absurde rrëzimi,
refuzojmë të mos ndjejmë atë parehati, e
themi jemi mirë ...?

Nuk ndalemi, metamorfozat s'janë thjesht
akte degradimi,
por harta lundrimi, pasi oqeani është
pronë e peshkaqenëve.
Ne vetëm sa kalojmë andej për të mbërritur
më shpejt,
në rrebelimin që të shpie tek pyetjet e
dyshimet ...

sepse në thelb diamanti, është një copë
qymyri
që duroi gjer në fund...

5 - Ndërsa pemët vdesin në këmbë ...

Kësaj ane të malit është e vështirë për ta
ditur,
nëse një maskë është komike,
e frikshme apo e tmerrshme,
nga oxhaqet ku nuk del tym dimri.

Përposh, matanë rrugës, fusha sikur ka
vdekur,
duke thyer të gjitha siguritë.
Është një vazhdë aksidentesh,
dhe njeriu nuk ka jetuar kurrë në paqe.

Grija e muzgut apo grija e perëndive
ka hedhur përmbajtjen,
që është plakur vajtueshëm

për të ribërë gjithçka nga e para,
për te qetësuar kohën e zemëruar.

Në monopatin e kujtesës
dallohet shikimi i fëmijës,
formë dashurie dhe admirimi
për këtë plak shumë të shëmtuar.
A nuk ishte Sokrati i tillë dhe zotëronte
një shpirt aq të madh?

Dropulli është si një buzëqeshje
që i mungojnë gjysmat e dhëmbëve,
duke rreshqitur nga një histori e së kaluarës
në akullin e rrëzimit,
ndërsa pemët vdesin në këmbë ...

6 - Kërkon një rrugë arratie ...?

Kërkon një rrugë arratie vijës së ftohtë të
agut (në zbardhtë),
si feksje, si brinjë, që s'di ku humbet golles
të zezë të natës.
Të shohin se je gati të hipësh mbi kalë,
A mundesh shurdhimet, pandehmat ti
lësh pas,
a ti ndalësh?

Arratia ka ndërgjegjen e vet të çmendur, të
panjohur,
Retë enden të zeza, klithin kur të shohin
gati për të ikur,
Dikush poshtë barkut pret rrypin e kalit, të
biesh, të thyesh kokën,
kurse tjetri i shkull patkojtë dhe merr
kamxhikun...

Më bujari, ai që zëra lumi dëgjon, rrjedhën
e rrjedhës,
afrohet të shndërrohet në lëndë miti, me
armë në dorë.
Ç'farë tundimi ekzistenca, shuar ngadalë
mitrës së pjellës,
shenjuar të qëllojë mu në kraharor ...

Kërkon një rrugë arratie vijës së ftohtë të
agut për të ikur,
fytazi a je bërë gati të ndeshesh me rrezi-
kun,
çdo herë i braktisur ...?

7- Zogjtë Kagaro mbi oqean ...

Këndojnë zogjtë Kagaro mbi oqean,
qiell' i natës vajtimin dërgon larg,
matanë.

Paqësori sonte qenka llahtaruar.
Egërshan, zemërak, dallgë,
gjëmon kabanë,
sikur diçka të pistë, të vjetër
po e mbyt natës ngadalë.

Këndojnë a ngashërehen
zogjtë Kagaro mbi oqean?

Ngashërehen, ngashërehen
zogjtë Kagaro mbi oqean,
drit' e parë e agut kontinental,
nxjerr kryet,
fshikëzës së çarë ...

Zogjtë Kagaro mbi oqean ...

8- Adoleshent ...

a- Vrapoja ...

Vrapoja të kapja gjithë pikat e shiut
që ti të mos lageshe.
Qeshnin gjetet e mështeknave,
pëlqenin leximin dhe heshtjen ...

b- Pikturat ...

Piktur s'duhet të jetë djaloshi,
që zhgaravit piktura nëpër mure.
Ndërsa muret i pshurin qentë...

c- Njerëzit ...

Njerëzit janë të sjellshëm,
nuk thonë gjithnjë të vërtetën,
pëlqejnë gjërat e lehta,
s'duan të lëndohen.
Pjesa tjetër: rrënjë të shkullura ...

d- Shpresa ...

Shpresa është si kalë i çalë,
duhet guxim që ta vrasësh.
Askush nuk beson Shën Judën,
shenjtorin e kauzave të humbura...

e- Adoleshent ...

Adoleshent - hormon në lëvizje,
Vendimin e zgjuar sjell përvoja,
përvoja ngjizur nga gabimet.
Kureshtia vrau macen.

9- EKZOTIKAT

a- Ekzotikat ...

Qyteti ekzotikave po shndrin këtë natë,
s'ka shndritur kurrë kaq fort.
Ka shumë heshtje të tij që nuk i tregon.
Pret vështrimin në sytë e dikujt,
për të ndezur qiejt.

b- Ai...

Nuk e dinte nëse ishte ritmi i duhur,
diçka kishte ndodhur.
Kërçyen dhe e çuan ritmin në qiell.
Ndihej shumë mirë kur thyeshin qelqet,
pa u shqetësuar nëse ky
quhej rrebelim.

c- Zjarr ...

Ekzotikat shkullën flokët për kohën e
humbur,
le të ndërrojmë rolet.
A mund të ndezim një zjarr në rrugë,
për të ngrohur ndjenjën
e lënë në harresë?

d- Ajo ...

Ajo kishte kapur një ndjesi,
hodhi hapin e shkujdesur.
Sekretet fshehin shumë çmenduri,
s'do ta harronte asnjëherë flakën.
Dramat janë për budallenjtë e plakur ...

Përmes Mesdheut...

Erërat ishin të mbara,
Eoli ish plakur,
s'kish më fuqi
të frynte, hapte kacakët.
Sirenat, po ashtu,
ishin bërë pronare të shtëpive
publike,
amazonave harku, shigjetat
nga kohrat u ishin ndryshkur,
Odisea në prehrin e një tjetre kish
vdekur,
në sa Penelopa shpresëhumbur
përsëri kish filluar
të endëte...
Ne lundrojmë përmes Mesdheut
e dritëza të largëta
tej dridhshëm vegojnë...
-Kasandra, bijë e Priamit,
a parasheh kund tjetër
ndonjë Trojë?

Kur burrat flenë

Kur burrat flenë
malet mendueshëm
marrin frymë
nën dritën blu
të ditës që sapo feks.

E gratë,
në sa në gjumë qeshin,
në lëndina të lulëzuara
ëndrrat i kthejnë...

Në ag gjithçka hesht
e unë përhumur,
rri e dëgjoj.

Ti, shkëlqim meteori

Ti, shkëlqim i beftë meteori,
merrmë me vete,
që të harroj si ecën koha...

* * *

Çantën, këpucët
i kam të modës së vjetër,
pelicën të shekullit të kaluar...
I ruaj nga pluhurat, mola
i vesh në ditë të veçanta
Apo në ditë të diel.

I ndjej tek më shohin me çudi
si sapodalë nga komeditë
e luajtura hershëm..
Po vetë eci me kujtimet e mija
(në ajrin që vallëzon rreth meje)
Si çupërlinë para shumë vjetësh...

Kur largohem nga Shkodra

Ky diell i përflakur më ndjek
duke u fshehur mes drurëve,
plepnajës që lehtas frymëmerr,
kodrave të blerta veshur me kith,
e ujrave të liqenit, ndër shelgje.

Ky diell më ndjek që tej në udhëtim,
skuqur nga malli, dashuria,
fshihet si fytyra e përplotur e nënës
pas perdes në largimet e mija...

SHPRESA KAPISYZI**Ti, grimcë pluhuri****Poezi****Kopsa**

Një kopsë të zbërthyer
në bluzën e kaltër
të gruas fytyrëgjëllore
e shigjetojnë vështrime
me zjarr vetëtimash.
Dy pëllumba frymëmarrin
gugasin, gati për fluturim
nën bluzën me kopsën blu,
të hapur si rastësisht.
Aty vdesin vështrimet
me zjarrin e vetëtimave.

O grua fytyrë ëngjëllore
me magji vështrimesh
mbështjellë,
e shpërthim të beftë,
është faji i kopsës së zbërthyer,
i vegimit të shtegut të pranvertë.

Agimi zbret gjithë drojë në Tiranë

Agimi zbret gjithë drojë në Tiranë,
hapësirave mes betonesh,
(gjithë arna qielli
si cohë e vjetër nderet),
veç një çast arrij ta shoh.
Kokën kthen, më sheh,
s'arrin t'më përshëndesë,
e ikën, zhduket
mes konstruksionesh të ftohtë.
Pyll hijesh më zë shikimin,
trishtueshëm pres më kot
të shoh një zog në fluturim,
Një cicërimë të dëgjoj...

Veten s'e njoha

M'u thye pasqyra
në dhjetra copa.
Dhjetra palë sy shihnin
brenda meje.
Ku të fshihesha?!

Si degë lulevile
zhveshur, rrëzuar nga erërat
mbeta.
Dhjetra palë sy më shihnin.
S'e njoha veten...

Bie shi në Paris

Bie shi në Paris,
nën një qiell gri,
që rrallë di të qeshë.
E çuditërisht fryn
një erë tekanjoze
si e marrë,
si dikur në Lezhë...

Si ky qiell i trishtë
dënes zemra ime,
ndërsa marr metronë
për aeroport,
tek preka në xhep
një shumë të hollash,
që vajza në ndarje
fshehtas m'i kish vënë.

Veç zemra

Shumë gjëra po më tradhëtojnë:
Veshët më janë rënduar
(duket dëgjuar kanë më shumë se
ç'duhet).
Sytë më kanë zënë perde
(më shumë se ç'duhet, po ashtu, do
kenë parë).
Mendja harron e çfarë nuk sajon,
(siç duket, më mirë të marrë
arratinë),
organet me radhë, me radhë...

Veç zemra,
si zog i strukur mes tufanesh,
lehtë më pëshpërit "Tak, tak, tak...,
deri në fund do të jemi bashkë"

Peizazh

Përbindësja, dema të egërsuar
si në arenë përleshën, enden qiejsh.
Gjëmojnë, kapërthehen, shfryjnë,
u shkëndijojnë thundrat në vrapim,
gjithçka lart nxin, nxin.

Mbas ndeshjes si ushtri e
shpartalluar
nga fushëbeteja largohen në çdo anë,
qielli hap gjoksin gjithë dhimbje,
dielli në mes si plagë...

Akuarium

Të gjithë si në një akuarium,
me qetësinë, heshtjen e peshkut,
shtynë ditët në ujra që s'ndërrojnë,
njësoj ditë-nata, të katër stinët
njësoj.

Tej reve të bardha si trëndafilë,
a plepnajës netëve larë me hënë,
tej ditëve, stinëve, ujrave pa jetë,
larg, larg, ku drita zë fill,
i lirë endet një poet.

Në djall google earth

1

Nga malli i hershëm
riçelin jargavanët
e kacavirren në trupin tim,
tufa pëllumbash më pas
pushtojnë qiejt
e këmbët padashur më çojnë
në kopshtet e blertë
plot karafilë...
Në internet kurrkund nuk i gjej.

2

Malli i hershëm
Si fëmijë për dore më merr,
më çon në vende,
ku s'mund të shkoj më,
në vende të përrallta
që veç në hartat brenda meje,
mund t'i gjej.

Kurrkund nuk e gjej atë rrugicë
me shtëpi mes gjelbërimit fshehur
në asnjë program në internet...

Në djall, në djall google earth!

Kur dita feks

Deri në agim të përgjoj
frymëmarrjen,
rrahjet e zemrës
nën dorën time,
mbështetur si zog,
i trembur nga ngricat e para,
në anën e majtë, në gjoks.
Përgjoj,
deri sa nga majat e kaltra
si vajzë e bukur
drita feks
gjithë drojë.

Nën hapat e jargavantë
të ditës, që vjen,
butësisht më pëshpërit:
"Pashë një ëndërr të bukur
Me ty mbrëmë..."

Ti, grimcë pluhuri

Një grimcë pluhuri
endet në ajër.
Tek duket e zhduket
nën rrezet e diellit,
që hyn në dhomë,
e shoh.

Ç'ke qenë ti grimcëz e vogël?

I deja më e bukur mes shumë të bukurave, Iqë mpleksen në aventurat e Pinokut del në rreshtat e parë të librit. Brenda copës së thjeshtë të drurit për zjarr, të ndodhur s'dihet se si në dyqanin e mjeshtër Qershisë, rri fshehur "një zëth i hollë i hollë", që ankohet nga dhimbja apo qesh nga gudulisja. Nga del ai zë i mbyllur në dru? Kush është ai xhind, ai Homunkulus, ai 'elf' i parespektueshëm e i pavlerësuar, që endet prapa kuintave të botës? S'dimë të përgjigjemi. Vetëm një gjë është e qartë. Pinoku jeton, ka një psikologji dhe një formë përsosmërisht të përvijuar, akoma para se Xhepetoja të fillonte ta gdhendte e t'i gjente një emër. Pa vënë kurrë këmbë mbi tokë, zotëron një përvojë shumë të sigurt për jetën tonë: di çfarë është puna dhe jeta endacake, fëmijëria e pleqëria, çfarë joshesh prekin zemrën e një njeriu, si duhet gatuar një vezë e si duhet qeruar një dardhë. Kështu asnjë lexues nuk çuditet nëse të gjithë personazhet- kukullat e Zjarrngënësit, Bulkthi që flet, zogu që sapo del nga veza, maçoku e dhelpra- e njohin pa e pasë takuar kurrë: sikur një bashkëpunim i fshehtë; apo informacione të cilave nuk ua dimë burimin, i shtyjnë drejt qendrës së librit të tyre.

Ndonjë orë pas shfaqjes në dyqanin e mjeshtër Qershisë, Pinoku pëson mishërimin e parë. "Zëthi i hollë i hollë", herë përqeshës herë i përvaishëm, ka një fytyrë, një hundë, një trup një veshje prej letre me lule dhe zë vend në galerinë universale të kukullave. Deri në fund të librit një ndryshim i pakapërcyeshëm do të vazhdojë ta mbajë larg nesh. Ndërsa ne i njohim në shpirt reagimet e fundit që na ndodhin në trup, bëhemi melankolikë për shkak të një ftohjeje ose të gëzuar nëse murlani pastron befaz retë nga qielli, Pinoku ka një trup që nuk i përket. Këmbët marrin zjarr dhe karbonizohen pa vuajtur ai; dhe thikat e gjata e të mprehta të vrasësve copëtohen pas shpinës së tij të fortë, të fortë si mendja e tij shpotitëse. Por, pikërisht se nuk i përket, trupi i Pinokut nuk e njeh përtësën e materies dhe u lëshon të gjithëve dëshirat e fantazisë fëminore. Ndoshta nuk e kuptojmë kurrë kaq qartë Pinokun, si kur përshkon fushat e Toskanës e të Përrallës, duke kërcyer "rripa shumë të lartë, gjerdhe shkurresh e hendeqe plot me ujë me shpejtësinë e një langoi apo të një lepuri të ndjekur nga gjahtarët; ose kur noton në det, bën kërcime e laradashë me lehtësinë e një "delfini në qejf".

Çfarë mund të bëjë një kukull e rënë në botën e njerëzve? Mund të përshkojë dy rrugë: të kërkojë të na ngajë; ose t'u rezistojë ligjeve të ekzistencës sonë, duke u kundërvënë lehtësinë e vet, shpejtësinë e vet dhe hirin e automatizimeve të vet, që- siç thoshte Kleist- riprodhojnë diçka nga hiri i zotit. Nuk dua ta bëj Kolodin një shkrimtar romantik. Por të paktën një herë në jetën e vet, ide të ngjashme me ato të Kleist e të Hofman i erdhën në mendje. Në atë kryevepër të çuditshme 'Pinoku' që është 'Majmuni me ngjyrë të kuqe', protagonist i vogël reziston të ulërijë e të qajë ndaj atij që- pikërisht Zana me flokë të kaltër- do ta shndërron në një "përbindësh të frikshëm": një genie njerëzore.

Pinoku zgjedh rrugën e parë. Edhe pse është kaq thellësisht kukull, nuk bën asnjë përpjekje për të mbrojtur natyrën e vet: kërcimet, laradashët, vrapimet marramendëse, lojërat e papërgjegjshme për të brofur si peshk. Tek ai, kaq i fortë e tallës, ekziston një prirje njëlloje e fortë që e shtyn të ndryshojë e të bëhet një qen i shkëlqyer roje, një shkollar i përsosur, një gomar i pakrahasueshëm dhe në fund një fëmijë i mirë". Kështu ai pranon të rritet, të bindet, të shkojë në shkollë; dhe detyron fantazinë e tij përpërëse- një fantazi romancier a mitomani më shumë

Pinoku- një përrallë e misterhme ezoterike

nga Zija Vukaj

"Druri nga është prerë Pinoku, është njerëzimi, është ai që ngrihet në këmbë dhe hyn në jetë si njeriu që ndërmer rishtarinë e tij; kukull: por krejt shpirtëror."


(Benedetto Croce)

se e një fëmije- në kufijtë tepër të ngushtë të realitetit. Asnjë keqardhje për botën e tij të zërave e të shpirtave, të drurit e të kuintave teatrale duket se nuk e prek. Një dëshirë thujse e dëshpëruar afektive e shtyn "si gjithë fëmijët e tjerë", drejt një babai e një nëne. Pak gjëra më duken më mallëngjyese se sa përpjekja e tij e pafajshme për të ndërtuar me imagjinatë një të kaluar të gjatë, bashkë me Xhepeton, ndërsa ka jetuar me të pak orë; dhe në shikimet e dashura, puthjet e zjarrta që i hedh "thujse jashtë vetes" zanës me flokë të kaltër.

Në fillim të kapitullit të shtatëmbëdhjetë, "Aventurat e Pinokut" ndryshojnë ton. Ai realitet i kufizuar, ajo Toskanë bujqësore e pastër dhe e varfër, e mbushur me pleq tekanjozë, me mejhanexhinj të paskrupull, me karabinierë e batakçinj shtinjakë e mizorë, befaz vizitohet nga një vegim. Ja tek del nga pemët e errëta të një pylli Zana e përrallave të vjetra: e pavdekshmja Zonja

e Kafshëve, Mbretëresha e Metamorfozave, Endësja e matur dhe skrupuloze e fateve. Siç është e natyrshme, Zana mbulohet pas dukjes më të thjeshtë, mes karrameleve lulakrave dhe sheqerkave e pijeve të ëmbla; dhe i shfaqet Pinokut në formën e motrës- nënës edukatores, aq e dashur për traditën romantike. Asnjë gjurmë tërheqjeje erotike nuk jep as nga larg figura e saj, që është e lidhur me ndonjë marrëdhënie të errët me mbretërinë e zbehtë të vdekjes, si shumë heroina të Dikensit, që i ngajnë thellësisht. Tashmë libri e ka gjetur kulmin e vet. S'ka rëndësi se në të gjithë tregimin Zoti nuk përmendet asnjëherë dhe nuk ka asnjë gjurmë figure atërore. Figura e buzëqeshur mëmësore zë pa konkurrentë horizontin që i mbivendoset kthesës së ngjarjeve tokësore.

Sapo shfaqet në skenë, Zana me flokë të kaltër e mbisundon tregimin: end, tjerr, përgatit fate, planifikon Aventura; dhe ndërkaq fshihet, shndërrohet e trajtësohet,



herë e bardhë si një imazh dylli, herë Vogëlushja e bukur me flokë të kaltër, herë si banore që punon në ishullin e Bletëve, herë zonjë me medalion, herë keç i kaltër, herë e sëmure në fund të një shtrati spitali. Kështu edhe Pinoku, i ardhur nën shenjën e Mbretëreshës së Metamorfozave, duhet të shndërrohet. Aventurat e tij, që deri tani kishin qenë rastësore dhe rraguese si në një roman pikaresk, fillojnë të përvijojnë linjën e një nisme.

Etapat e kësaj nisme janë të njohura. Si në shumë tregime simbolike, një çast para gjysmës së fundit, mëkati më i rëndë i ekzistencës së tij ndërpret ngjitjen e ngadaltë të Pinokut. Në natën e errët e tinëzare që po mbështjell tokën, ai dëgjon fjalët tunduese të StërHELLIT, shkon me të në vendin e lodrave dhe bëhet gomar, duke zbritur kështu nën natyrën e tij prej kukulle, meqë gomarët, të vetmit mes të gjithë personazheve njerëzorë e shtazorë të librit, flasin në "dialekt". Pastaj shitet për njëzet para, hidhet në det e mbytet. Në këtë moment, linja e fatit të tij përmbysset sërish. I hedhur pa mëshirë në humnerën e vdekjes, i flakur si një gur në detin e jetës, Pinoku ngrihet sërish drejt dritës. Ai nuk ka asnjë meritë për shpëtimin e vet: çlirohet për "hir" nga Zana, Zonja e Kafshëve, që çon një tufë peshqish për të përllarë trupin e tij prej gomari.

I çliuar nga veshjet e huaja, Pinoku rilind kukull; dhe përpëlitjet gazmore të ngjalës, laradashët e gëzueshëm të delfinit, kërcimet e lumtura që bën mbi sipërfaqen e detit, janë himni i gazmendit i atij që më në fund ka rigjetur formën e vet. Por ky gëzim nuk vazhdon gjatë. Për t'u "shndërruar" plotësisht, Pinoku duhet të heqë dorë nga vetvetja. Gjithçka ndodh një natë tjetër, ndriçuar nga shkëlqimi i yjeve e i hënës së plotë. Pinoku merr babain për dore, ngjit grykën e Peshkaqenit, noton me Xhepeton mbi supë dhe mbërrin tokën e sigurt. Kujdeset me dashuri për babain e sëmure, bën shporta dhe karroca dore, rrotullon rrethin me kova në vend të gomarit, mëson të lexojë e të shkruajë dhe kursen si një fshatar toskan. Kush do të njihje më në këtë djalë të fortë e punëtor, krijesën prej druri të lindur në një natë të largët dimri? Tashmë Pinoku është babai dhe zotëria i



I etur për risi në të gjitha fushat, me vetëbesim në mbartjen e një sasive të thellë njohje të re, krenar për shkollimin e vet dhe metodave të reja, brezi i Humanistëve, i armatosur me shtypshkronjë tashmë, u pozicionua në edukimin e botës në të gjithë artet dhe shkencat. Nga anatomia te aritmetika dhe nga piktura te metalurgjia, shtypshkronjat furnizonin traktate njohjeje. Aso kohe, shumica e tyre ishin në latinisht; gjuha e përbashkët e çdo vendi e cila ishte e kollajshme për t'u shtypur, dhe lexuesi ishte jo më me doemos kishtar. Kjo nuk nënkupton që Mesjeta kishte dështuar në shpërndarjen e përparimeve të njohjeve praktike, por kjo përpjekje ishte e ndaluar nga institucionet e saj. Mëkati i zanatçinjve e mbajti lojën e zanatit sekret; ato ishin pronësi me vlerë, sikur janë sot licencat dhe të drejtat e autorit. Nga një lojë fjalësh e pa vetëdijshme, në frëngjisht për fjalën – *métier* (zanat) – mendohet (gabimisht) se ka ardhur nga fjala – *mistère* (fshehtësi). Njeriu i shkencës – alkimistët dhe astrologët – gjithashtu përpiqeshin në fshehtësi për rezultate progresive. Nga fundi i shekullit të pesëmbëdhjetë e kënde, vënë në lëvizje nga një Individualizëm i porsa shfaqur dhe pastrues i mëkatit shpirtëror, të gjithë këta punëtorë të mendjes u mbështetën më tepër në talent se sa në sekrete që mbronin vlerat e shërbimeve të tyre. Duke përfutuar nga shpikjet e kohës, ata publikuan shpikjet e tyre në manuale të cilat jepnin të rejtat e fundit të teknikës. Një nga të parët i cili e ndjeu domosdoshmërinë e të dhënimit mësim ishte skulptori Ghilberti në mesin e shekullit të pesëmbëdhjetë. Ai ishte njëherazi i pari që besonte se artisti në jetë duhet të dokumentojë me shkrim mësimet e veta drejt shkollimit artizan. Në këtë pikëpamje të artizanit qëndron embrioni i një tipi të ri social, Artisti. Ai ose ajo nuk ishte më një aktor dosido i manualeve të vendosura me kanun, jo më i tërhequr prej hunde nga pushtetarë, por një individ i lirë i pazakontë për të krijuar. Traktatet e njohjes e mbajtën klasën e artistëve aktuale në raport me këto shpikje dhe krijime të reja. Pas Ghilbert-it, erdhi vërshimi. Më i shkëlqyeri, më i denji ndjekës i tij ishte Leone Battista Alberti, arkitekti i shekullit të pesëmbëdhjetë, i cili e konsideronte artin e vet njësh me skulpturën dhe pikturën dhe shkroi për ato vazhdimisht. Ndërtesat e reja kishin nevojë të stoliseshin, të vjetrat të dilnin në dritë, qarkuar me figura shtesë, skena murale me ngjyra, jetësore, akoma më mbresëlënëse se kurrë më parë. Sikundër edhe shokët e vet, Alberti ishte njeri praktikant. Ai skicoi plane të cilat, me disa përpunime, u rimorën nga Bramante, Michelangelo, Maderno, dhe Bernini për të krijuar monumentin më të shkëlqyer të Romës moderne, Shën Pjetrin. Kjo sipërmarrje konsiderohet si 'rilindja e Romës' në paralel me të shumë përfolurën rilindje të mendjes së qytetërimit perëndimor. Gjeneri i përlllogaritjes, Alberti shpalosi ide të qarta mbi rregullat e perspektivës për piktorët, dhe për tregtarët rregullat e përlllogaritjes dhe rezervimit. Traktatet e tij në arkitekturë në latinisht, u përkthyen në frëngjisht, italisht, spanjisht dhe anglisht. Shohim edhe njëherë këtu vlerën e shtypshkronjës për kohën. Një tjetër italian, Giorgio Vasari, i shtyrë nga pragu i shpërthimit artistik të kohës, e ndau energjinë e vet midis profesionit si piktor dhe ndërtues në Firence por edhe si biograf i mjeshtërive modern në trion e arteve madhështore të skicave e vizatimit arkitekturor. Përmbledhja e tij madhështore e *Jetëve* që është ndriçues ta lexosh jo vetëm si libër por njëherazi si burim unik i historisë së kulturës, ishte një interpretim i shkëlqyer i një epoke ku mungesa e organizimit do të thotë kërkim – jo si në bibliotekën kombëtare apo katalogët e librave – por më tepër si një bashkëbisedim apo regjistrim në magnetofon. Vasari donte të regjistronte shumë më tepër se fakte dhe data apo



JACQUES BARZUN

Artisti u lind

Përktheu nga origjinali Flurans Ilia

anekdota mbi komisionin e dhënies të projekteve madhore dhe zbatimin e tyre. Ai përshkruan teknikat dhe diskutimet si edhe meritat e tyre dhe vështirësitë, duke u shtuar përlllogaritjeve të tij teorinë e hapësirës, klimës, dhe vendit që provonte se Roma ishte jo e shëndetshme për njeriun dhe punën (ndotja e ajrit një parashikim i parakohshëm për epokën). Ndërkohë që Firence ishte ideale në të gjithë respektin e fjalës. Gjatë gjithë kohës, Vasari vë në dukje me bindje që lexuesi i tij duhet të vlerësojë përmirësimin e forcave të dëshmuara nga njeriu në këto vepra të cilat ai i quan "piktura të bukura" në paralel me "letrat e bukura". Kaq shumë dritë e depozituar në metodë dhe arritje përmes librave krijoi tundimin i cili qyshkur ka shoqëruar çdo zhvillim teknik: mbingarkesën e udhë rrëfimeve, manualët, dhe instruktivet e "jetëve". Forca e risive e prurjeve të Rilindjes Evropiane, krahas shkrimeve të Alberti-t, përfshin edhe punimet tashmë klasike: autobiografinë e Benvenuto Cellini-t dhe copëza monografish në skulptura të përshkallëzimit të vogël dhe artit të argjendarisë, traktatet e Palladio-s në ndërtim, skicat e Piero della Francesca-s, përshkrimet e Drer-it mbi pikturën dhe përmasat e njeriut, si edhe gjerësinë e pafundme të *Shënimeve* të Leonardo-s. Midis artistë-teoricienëve të tjerë të kësaj

epoke ka pasur edhe emra të njohur por që janë zbehur në ditët tona: Serlio, Filarete, Lomazzo, Zuccaro, Ammanati, Van Mander, Von Sandrart – të gjithë duke u marrë me të njëjtat tema, pothuajse të gjithë duke përshkruar imtësisht shkencën e re të perspektivës, disa të dhëna përfshijnë rregullat gjeometrike në detaje të shkëlqyera, e midis të tjerash, shumë këshilla të ndryshme, duke filluar nga rruga më e mirë e përzierjes së pigmenteve në trajtimin e duhur nga ndihmësit e tyre. Çfarë shënjon botuesin modern të këtyre teksteve është hapësira e dhënë në këto punime drejt rëndësisë për artistët që të kenë besim të vërtetë dhe moral të hekurt. Virtyti është i pa ndarë nga arti i vërtetë. Është fakt i mirëqenë që një vepër arti shpalos shpirtin e artistit po aq sa edhe mendjen e tij. Por ajo çka është më e rëndësishme, vepra e artit duhet ti bindet urdhrat pasqyrë të hierarkisë së urdhrave të botës, i cili është një urdhër moral. Qoftë nga intuita apo konventa, artisti duhet të dijë se si ta konvenojë këtë realitet. Prandaj (për ne sot) duket si i pa rëndësishëm injeksioni i traktateve. Për shembull, në *Shënime* e tij, Leonardo kërkon ndjesë që nuk është shkrimtar, por megjithatë ai e tregon veten si filozof të moralshëm, si psikolog, madje edhe si krijues i shëmbëlltyrave gjysmë të mistershme. Që të gjitha artet duhet të ishin

të moralshëm ishte një rregull i cili vazhdoi gjer në shekullin e nëntëmbëdhjetë, gjersa u çlirua nga përmbajtja e moralit, në saj të këndvështrimit të virtytit gjatë krijimit të karaktereve, sikur edhe nga pritshmëria e publikut.

Numri i madh i traktateve të Rilindjes Evropiane na thotë diçka rreth natyrës së kësaj lëvizjeje kulturore. Një tentim të bënë të mendosh se çfarë e bënë emrin e Rilindjes të përbërë nga një grusht gjenish me një grupim të madh admiruesish, pronarë, dhe mbështetës të artikulluar emrat e të cilëve shfaqen si shënime me shkronja të vogla. Aktualisht, është një turmë e madhe dhuratë e përbërë nga njerëz të ngritur – kjo masë ishte e pa përshkruar. Ky është veç një përgjithësim. Sepse këta bashkëpunëtorë duhet të kenë qenë talente të shkëlqyera, jo ashure. Ata mund të ishin të paformuar plotësisht ose të pa fat si krijues, emrat e tyre mund të ngelen ose zbehen, por në retrospektivë ne shohim se ky apo ai person ndihmuan në fakt në idetë origjinale, dhe ishin të parët që patën fatin të përdornin objektet e shpikjeve mekanike të Rilindjes. Së bashku në atë çfarë bënin dhe diskutonin, ata ndihmuan në gatimin e këtij ngazëllimi produktiv; ata përndezën gjenin në mendjet e tyre; ata ishin mushka e nevojshme për ngjitjen e të përpjetës të kësaj epoke tërësisht të veçantë. Ky refleksion shkon drejt përgjigjes së pyetjes tonë kur habiteshim dikur se çfarë kushtesh sjellin në jetë perioda të shkëlqyera artistike, në dukje rastësore, këtu apo atje, dhe për një kohë të shkurtër relative. Nuk është, ashtu si mendon dikush, zhvillimi, apo mbështetja e një qeverie të mençur, apo magjia e paqes dhe qetësisë – Firence në shkëlqimin e saj ishte në konflikte të përhershme brenda dhe jashtë. Arsenalin e parë është sigurisht grumbullimi i mendjeve të etura në një vend të caktuar. Ndoshta ato mendje nuk ishin në vendin e nisjes me këtë ide në kokë; por ato erdhën në mënyrë të mistershme nga të gjitha anët, bash në kohën kur disa goditje kulturore erdhën zhurmshëm gjerësisht, bash kur u shfaqën disa arritje vendimtare në kuptimin teknik, i hodhi ato mendje sak në vendin e origjinës së tyre. Sikur përhapja e temperamentit revolucionar, ethet e interesit, kundërshtitë, rivaliteti midis veprave të artistëve, krahasimi midis tyre, dhe debati ndërmjet, përftoi temperaturën e nevojshme që e rriti preformizmin ndërmjet normave. Duhet qindra prej këtyre talentëve për të prodhuar gjashtë a shtatë persona të shkëlqyer në realitet. Gjeneri i zbuluar me vonesë që për fatin e tij të keq duhet të punojë i ngujuar është një i mbijetuar i vetmisë dhe shpesh i paralizuar nga kjo vetmi. Në epokat më të mira praktika i paraprin teorisë – punë përpara nocioneve. Por sërish, në epokat e ndritura, derivati i teorisë nga praktika na thotë diçka (jo gjithçka) mbi synimin e ajkës së artistëve dhe kriteret e vënies në jetë të veprave të tyre. Ky kuvend i përbashkët artistësh qëndroi në këmbë për 400 vite dhe nuk duhet anashkaluar vetëm e vetëm për ti bërë qejfin kritikëve të fundshekullit të njëzetë të cilët si synim të vetëm kishin si e si të zhvishnin synimet artistike të artit. Traktatet e Rilindjes Evropiane shpallin se përveç misionit të vet moral, detyra e artistit (në këtë mënyrë synimi i tij) është të imitojë natyrën. Artisti duhet çast pas çasti të vëzhgojë "stolin e Krijuesit", e vetmja rrugë për të adhuruar mëmën natyrë. Kjo disiplinë karakterizon paralelisht shkencëtarët, dhe më shumë se një artist i epokës mendonte mu si "filozof natyral". Asnjë "kulturë mëdyshjeje" gjer në këtë pikë nuk ja doli mbanë të përçaj këto mendje të ndritura të epokës. Edhe pse në Mesjetë format natyrale shërbenin si skica fillestare të veprave të artistëve, mesjetarët nuk ndiheshin të detyruar të kopjonin natyrën me besim. Synimi i ndryshëm i Humanistit qëndron në





Fituesit e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023




Romani më i mirë:
Besnik Mustafaj
“Fati i marrë”
Onufri




Vëllimi poetik më i
mirë:
Entela Tabaku
“Qeramikiana”
Onufri




Libri më i mirë
për fëmijë
Lediona Braho
“Kroni dhe
pulbardha”
Albas



Përkthimi më i mirë
Anna Kove
Günter Grass,
“Daullja prej
llamarine”
Albas



Vëllimi më i mirë me
tregime:
Shpëtim Kelmendi
“Dashnia asht”
Zenit



Vepra më e mirë
studimore
Pëllumb Xhufi
“Shqipëria dhe
fundshekulli i
dëshpëruar”
Dituria